

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 245, Mars 2024

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Studiuesi Dr. Mark Palnikaj në bibliotekën "Marin Barleti"

Me datën 9 mars 2024, dite e Shtune, Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" në bashkëpunim me bibliotekën e qytetit "Marin Barleti" u bë paraqitja e studiuesit e publicistit Dr. Mark Palnikaj, në prezencën e anëtareve të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", shkrimtar e poet, miq të autorit. Gjithashtu mori pjesë deputetja e Shkodrës Emilia Koliqi, Konsulli i Nderit të RA në Shkodër Gjergj Leqejza, Mjeshtri I Madh Gjon Dukgilaj, Kolonel Flamur Muça, Majlinda Laçaj, Dukate Bregu, Ndoc Ashta, Prelë Shtyani, Nikolin Qafanena, Gjon Vojvoda, Sander Rroku, Maumur Vuçi e përfaqësues të mediave lokale e plotë të tjerë me një sallë elitare.

Kush është Dr. Mark Palnikaj? Kush është Dr. Mark Palnikaj? Zoti Mark ka lindur me 24 shtator 1954, në fshatin Curraj, të krahinës Nikaj. Në vitin 1978 ka përfunduar shkollimin e larte për inxhinier mekanik dhe specializuar jashtë nëntor 1996 - dhjetor 1998, shkruan e flete Italisht, dhe kupton mirë Anglisht, Ruisht dhe Frëngjisht. Zoti Mark ka një eksperience të madhe pune, që nga mekanik, inxhinier, Kryeinxhinier dhe deri në detyrën e Drejtorit Autokoncesionarise, MAN në Tiranë, në vitin 2012-2014.

Marku ka një kontribut të rëndësishëm eshë në shkollim e nxënësve e studenteve, në shkolla e mesme të bashkuar në Tiranë dhe deri në detyrën e pedagogut në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, dhe ka dhanë leksione në shkollat...



Jeta vdes atje ku vdes pylli

Kur hap "portën" gjigante të pyllit, një ndjesi e bukur e ëmbël të pushton. Ndjen ngadhënjim, krenari dhe madhështi. Kur jeni në pyll, fillon pastrimi i trurit dhe i zemrës, lemë jashtë tij pasionet e këqija, zemërimin, stresin, ankthin, xhelozinë dhe përpiqemi të përjetojmë çdo moment. Çdo gjë këtu ka jetë dhe kjo jetë të befason. Një jetë që është produkt i energjisë diellore e gjen në dru, në kurorë, në tokë dhe nën tokë. Këtu çdo qenie "ha diell", jeton nga dielli, ngrohet me diell, merr frymë nga dielli dhe i përulet magjishëm diellit. Këtu jeta, dashuria, miqësia, bukuria, poezia, muzika, miqësia, madhështia..... marrin një kuptim dhe një përmasë tjetër. Vazhdoj rrugëtimin nën mbretërinë e drurëve, dhe magjia e tyre më shoqëron në çdo hap. Drurët nuk nxitojnë, nuk vrapojnë siç bëjnë njerëzit, ato rriten ngadalë, shumë ngadalë dhe kjo dukuri i shoqëron gjithë jetën. Ja le të shikojmë shumëzim dhe shtimin e tyre. Është mistike ato i marrin masat një vit më përpara. Halorët pothuaj frutifikojnë çdo vit, ndërsa fletoret kanë një programim tjetër, ato frutifikojnë 1-3 vjet. Kur fara bie në tokë në vjeshtë, logjikisht duhet të rrënjëzojë, por nuk ndodh një gjë e tillë. Po të çelin menjëherë do të përballën me dy probleme. Ato nuk do të përballojnë ngricat e dimrit dhe do të vdesin, dhe me vdekjen e tyre nuk do të shpëtojnë ngrënies nga kafshët. Në këtë periudhë ka mungesë të theksuar ushqimi.



Një feste për të mos u harruar...

Për mësuesit në pension të krahinës së Shalës, të Pultit e Shoshit festa e 7 Marsit e këtij viti ishte diçka shumë e bukur dhe e veçantë në saj të nismës së dy kolegeve tonë të nderuar z. Luigj Shtyti dhe Prele Shtyani, të cilët organizuan takimin tonë, i cili ishte shumë mbresëlënës dhe i paharrueshëm.

Hapja e shkollës së parë në gjuhën shqipe në vitin 1887, ishte vepër madhore, sepse kishin kaluar shekuj që ndalohej gjuha shqipe, ndalohej të mësuarit shkrim e këndim në gjuhën e nënës. U deshën shumë mundë e djersë, gjak e sakrificë për të arritur në këtë ditë të bekuar.

Reformat e arsimit kanë mbetur në letër?!

Reformimi i shkollës është një sistem shumplanesh dhe rezultat i bashkëndikimit dhe bashkëpunimit të shumë faktorëve e aktorëve, jep ndikimin e tij në harmonizimin e mirë të faktorëve që ndikojnë drejtpërsëdrejti në reformën e nisur, e cila do të bënte të mundur që të funksiononte më së miri mekanizmi i drejtimit dhe i menaxhimit subjektiv të arsimit. Arsimi nuk është një përmash subjektive që kanë mbetur në letër, por një projekt inteligjent që kërkohet një menaxhim intelektual ...

"Ku del Kiri" natyrë magjepsë me shtegtime të panjohura ekoturistike

Ka më shumë se një vit që lugina e Kirit dhe rruga e Dukagjinit kanë marrë një vëmendje të madhe jo vetëm mediatike, por dhe me veprimtari drejtpërdrejt në terren. Është rruga automobilistike në luginën e Kirit në ndërtim që do lidhet me Breg-Lumin e Shalës, duke kaluar nëpër fshatrat e Shoshit, që ka zgjuar interesat tona, shpresë të banorëve ...

Dua të pi verë Çamërie

"Internari" poetik i këtij autori është një autostradë nga ku veçojnë tri korsi: Misioni si poet për t'i kënduar atdheut, flamurit dhe lirisë në mënyrën më të mirë, pasqyrimi i sakrificave supreme për atdheun e lirinë si dhe mirënjohja e vlerësimit për të gjithë ata që dhanë jetën dhe gjakun për çlirimin e Kosovës, për Çamërinë dhe trojet etnike.

Poezitë e tij përshkojnë një rrugëtim të gjatë historik, fokusohen në pikat kulmore të këtij rrugëtimi, në personazhet më tipikë nga ata mitologjikë si Gjergj Elez Alia, Agroni e Teuta, Skënderbeu e deri në Jasharët e ditëve tona.

"Aireali" i tij poetik është një shtet Kosovë, Shqipëri, Çamëri, ...

Studiuesi Dr. Mark Palnikaj në bibliotekën “Marin Barleti”

Me datën 9 mars 2024, dite e Shtune, Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” në bashkëpunim me bibliotekën e qytetit “Marin Barleti” u bë paraqitja e studiuesit e publicistit Dr. Mark Palnikaj, në prezencën e anëtareve të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, shkrimtar e poet, miq të autorit. Gjithashtu mori pjesë deputetja e Shkodrës Emilia Koliqi, Konsulli i Nderit të RA në Shkodër Gjergj Leqejza, Mjeshtri I Madh Gjon Dukgilaj, Kolonel Flamur Muça, Majlinda Laçaj, Dukate Bregu, Ndoc Ashta, Prelë Shytani, Nikolin Qafanena, Gjon Vojvoda, Sander Rroku, Maumur Vuçi e përfaqësues të mediave lokale e plotë të tjerë me një sallë elitare.

Kush është Dr. Mark Palnikaj?

Zoti Mark ka lindur me 24 shtator 1954, në fshatin Curraj, të krahinës Nikaj.

Në vitin 1978 ka përfunduar shkollimin e larte për inxhinier mekanik dhe specializuar jashtë nëntor 1996 - dhjetor 1998, shkruan e flete Italisht, dhe kupton mirë Anglisht, Rusisht dhe Frëngjisht

Zoti Mark ka një eksperience të madhe pune, që nga mekanik, inxhinier, Kryeinxhinier dhe deri në detyrën e Drejtorit Autokoncesionarise, MAN në Tiranë, në vitin 2012-2014.

Marku ka një kontribut të rëndësishëm eshë në shkollim e nxënësve e studenteve, në shkolla e mesme të bashkuar në Fierze dhe deri në detyrën e pedagogut në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës, dhe ka dhanë leksione në shkollat profesionale në Gostivar, Kumanovë e Gjakovë, në Universitetin e Tetovës, Shkupit, Ferizaj e Prishtinë.

Gjithashtu ka një kontribut të mirë në detyrat shoqërore në gjitha fushat e jetës, kryesisht në detyrën e anëtarit të Këshillit Bashkiak në Bajram Curr.

Doktor Marku ka një kontribut mjaft të rëndësishme hulumtuese, studiuese e publikuese.

Në fushën shkencore ka 11 botime;

Në fushën me karakter historik ka 16 botime.

Doktor Marku ka me dhjetëra artikuj shkencorë, historik dhe social që ka botuar në shtypin e ditës dhe dhjetëra emisione TV brenda vendit deri në Prishtinë e Maqedoninë e Veriut dhe jashtë vendit

Dr. Marku ka një pune të madhe hulumtuese e studiuese, duke hy në arkivin e dokumenteve me dorëshkrim në Arkivin e Shtetit në Venecia, në Arkivin e librave dhe dokumenteve antike në Padova, në arkivin historik dhe biblioteka te shtëpia e Shenjtë, në Loreto, në bibliotekën Komunale në qytetin e Feros, në APF në Romë, në ARSI, në Vatikan, në Bibliotekën Apostolike, në Arkivi e Manastirit të Grottaferrates, në Arkivin e Shtetit në qytetin e Napolit dhe në arkivin e bibliotekës kombëtare në Napoli.

Ka kryer kërkime edhe në arkivi qendror të shtetit tonë, në arkivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në disa arkiva kishtarë dioqezane.

Ka marrë nga Arkivi Sekret e Vatikanit

dhe nga Arkivi i Propagandës Fide në Vatikan 2700 faqe dokumente arkivore me rëndësi të madhe për historinë e Kosovës dhe aktualisht po punon për publikimin e tyre në gjuhën shqipe.

Pas prezantimit të Dr. Mark Palnikes, fjalën e mori studiuesi, poeti e publicist Prele Milani, i cili në mes të tjerave



u ndal: “Dr. Mark Palnikaj zbrazti sot në Bibliotekën “Marin Barleti” një turrë librash dhe dokumentesh të rrallë autentik, plotësisht si Dhaskal Todri shkronjat prej tunxhi, kur ende nuk lejohej të shkruhej e bukura shqipe. Kurrë më pare Shkodra, Pulati dhe Dukagjini në një festim librash ne një kohe aq të shkurtër nuk patën dhuratë një gomile të tillë librash, relacionesh dhe dokumentesh historikë si sot. Monografia “Pulti, një histori 1250 vjeçare”, “Relacionet” e plota të Shtjefen Gasprit, “Relacioni” Sinoptik i Bucciarellit”. Botimet e plota të Kamilo Libardit, Gjergj Kastrioti letërkëmbimi me sulltanët,

si dhe plot 17 botime historike, dokumentuar me burime të dorës së pare të gjetura në arkivat Vatikanit, Napolit dhe Grottoferrates Napolit e të Vjenës. Kjo ngarkese kaq e rënde është fryt i një pune rrëmihëse 30 vjeçare me durim urithi të



nxjerra dritë pas netëve të gjatë të teratuar. Janë fakte, që flasin për here parë shqip.

Dr. Mark Palnikaj me pasionin e tij të “lajfitur” këputi me dana, drynin e ndryshkur të kanavetës së vjetërsuar, duke na thënë: “- Qe ku i keni të përziera bashkëfarën e hithrave me lakrën. Merreni e

itës Atdhetare “Dukagjini”, i dorëzojë titullin e larte, që i është dhanë z. Mark, me vendim nr. 280, date 4 mars 2024, “Anëtar Nderi Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, me motivacion: “Për kontribut të veçantë në hulumtimin dhe promovimin e dokumenteve historike me vlera të larta kombëtare, në pasqyrimin e historisë



ndani po patët durim. Mana ka shumë gjera që do doja të ishim ndryshe e druse mjaft pak do u pëlqejnë. Mos më mallkonin! Qebesa ua solla ashtu si i gjeta të fshehura në bri të dhisë. Veç ta dini se janë shkruar në ato kohëra, që nuk dinim të shkruanim vetë. Jemi popull i vogël dhe kemi bërë gabime jo të vogla historike”. Tu ritë ndera Mark Palnikaj!”

Pastaj ligjëroj Studiuesi e publicisti Luigj Shyti, i cili u ndal në vlerat e punës studimore të Dr. Markut.

Dr. Marku, në fjalën e tij prezantuese u ndal në vlerat historike kombëtare mbi dokumentet e hulumtuara, të nxjerra nga arkivat e Evropës, në veçanti në Vatikan e Napoli dhe që puna vijon ... Mbi rëndësinë e botimit e publikimit të tyre për studiuesit tone.


Mbas prezantimit të punës së tij, z. Luigj Shyti, në emër të Kryesisë së Shq-

së Pultit e të Dukagjinit dhe për bashkëpunimin e vijueshëm e të suksesshëm me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”.

Veprimtaria u mbyll me një fotografi e përbashkët përpara kësaj biblioteke, e pagëzuar me një emër të madh, me emrin “Marin Barleti”

Disa opinione për punën e Dr. Markut:

Deputete e Shkodrës znj. Emilia Koliqi, “Në paraqitjen e botimeve të hulumtuesit dhe studiuesit z. Mark Palnikaj, Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në bashkëpunim me Bibliotekën “Marin Barleti”, organizuan këtë veprimtari, ku z. Palnikaj foli për zbulimin dhe studimin e dokumenteve të vjetra shqipe, përmes të cilave ka gjetur prurje të reja për gjuhën shqipe dhe ka realizuar mjaft shkrime e libra në lëmin e historiografisë. Ai është një hulumtues i palodhur për të zbuluar një sërë dokumentesh në



Përkujtimore

Me 2 Mars 2024 Shkodër u kujtua 580 vjetorin e Besëlidhjes së Lezhës dhe 99 vjetorin e vrasjes së Heroit të Popullit Luigj Gurakuqit, që ngriti flamurin Shqiptar në Deçiq me Dede Gjon Lulin e me Mehmet Shpendin, në Prillin e 1911.

Morën pjesë e vendosen kurora me lule të busti i Luigj Gurakuqit:

Kryetari i Qarkut Shkodër Edmond Ndou, Prefektja e Qarkut Shkodër Majlinda Angoni, Përfaqësues nga Këshilli Bashkiak, Përfaqësues nga Bashkia Shkodër, Kryetari i PS Shkodër, Hilmi Lakti, Përfaqësues nga Shoqatat Ushtarake, ish Komandanti i Divizionit Shkodër Kolonel Flamur Muça, ish Shefi i Shtabit të

Divizionit Shkodër Kolonel Ndue Sanaj, ish Komandanti i Brigadës së Artilerisë Shkodër Kolonel Vuksan Vukaj, e përfaqësues nga ODA Shkodër .

Kjo veprimtari u organizua nga Komiteti i Veteranëve e Pasardhësve të LANÇ (Nderi i Kombit) Shkodër, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër

e institucionet qendrore shtetërore në Shkodër .

Foli për të pranishmit Kryetari i Komitetit të Veteranet të LANÇ Shkodër, zoti Zamir Llazani.

Major (p) Rexhep Sufaj



gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të huaj, në arkivat e bibliotekave perëndimore, në arkivat e Vatikanit, Venecias, Napolit. Botimi i fundit, ishte libri kushtuar veprimtarisë të pasur dhe të rëndësishme të At' Kamilo Libardit "Lëvizjet e para patriotike shqiptare, në vitet 1910-1911-1912" Një seri librash të z. Palnikaj, dëshmojnë punën e tij të palodhur dhe me shumë kosto individuale, për gjetjen e dokumenteve të pabotuar ndonjëherë në gjuhën shqipe. Këto dokumente, plotësojnë thesarin e historisë shqiptare të mesjetës dhe janë burim të dhënash për

historianët, për të shkruar me realitet historinë e Zonës së Veriut të Shqipërisë, e cila u shtrembërua me qëllim dhe ende vazhdon mos të shkruhet. Qëllimisht, është nënvlerësuar roli i shkollave shqipe të hapura nga klerikët deri në shekullin XIX, kur në gjithë kontinentin evropian, shkollat e para, janë hapur në fillim nga institucionet fetare".

N/Kolonel Dede Zhivani në pension, shkruan: "Kryesia e Shoqatës Atdhetare "DUKAGJINI", me nismën e saj organizoj promovimin e 10 botimeve të fundit, të hulumtuesit e studiuesit të jashtëzakon-

shëm, të historisë së Popullit e Kombit Shqiptarë Dr. Mark Palnikaj. Veprimtaria ishte shumë i mire organizuar, me dinjitet, ashtu siç bëhet, në traditën tashmë të konsoliduar të kësaj shoqate. Pjesëmarrja e auditorit ishte shumë cilësore dhe e gjithë veprimtaria u ndoq me shumë kureshtje, dashamirësi e interesim nga të pranishmit. Folësit në takim u shprehën me shumë vlerësim për punën e palodhur, përkushtimin e sakrificat e radha fizike, kohore e financiare të studiuesit Palnikaj në ndërmarrjen e Tij vullnetare, patriotike e atdhetare, në shërbim të nxjerrjes në

dritë të vërtetave të jetës e historisë Tonë Kombëtare, kjo me hulumtime e studime të rralla e të jashtëzakonshme në arkivat dokumentare ndërkombëtare. Me shumë interes, miratim e duartrokitje të zjarrta u prit nga të pranishmit, sidomos fjala prezantuese e Autorit, z. Palnikaj, për punën e tij hulumtuese, studimore e botuese. Ai në mënyrë shumë realiste, të besueshme dhe argumentuese pasqyroj punën e bërë të deritanishme dhe synimet për t'i avancuar ato, në të ardhmen".

Redaksia e gazetës

Një feste për të mos u harruar..

Për mësuesit në pension të krahinës së Shalës, të Pultit e Shoshit festa e 7 Marsit e këtij viti ishte diçka shumë e bukur dhe e veçantë në saj të nismës së dy kolegeve tonë të nderuar z. Luigj Shyti dhe Prele Shytani, të cilët organizuan takimin tonë, i cili ishte shumë mbresëlënës dhe i paharrueshëm.

Hapja e shkollës së parë në gjuhën shqipe në vitin 1887, ishte vepër madhore, sepse kishin kaluar shekuj që ndalohej gjuha shqipe, ndalohej të mësuarit shkrim e këndim në gjuhën e nënës. U deshën shumë mundë e djersë, gjak e sakrificë për të arritur në këtë ditë të bekuar.

U mbledhëm ish koleget e vjetër me përvojë shumë të gjata në fushën e shkollimit dhe me nostalgji kujtuam vitet e gjata të punës sonë, vështirësitë që kemi kaluar dhe punën e madhe që kemi bërë në këtë fushë me mbi 40 vite pune, që na i vlerësojnë nxënësit tonë, tani prindër të moshuar, të cilën e shprehin në respektin ndaj nesh në takimet rastësore dhe që ne kur komunikimin me ata, na drejtohen jo me emër, por me fjalën “mësues”, pavarësisht se një pjesë e mirë e tyre janë tani te thinjur dhe prindër të fëmijëve të rritur.

Tani është ndoshta e nevojshme të përmendim pjesëmarrësit në këtë takim, sepse lexuesit e këtyre radhëve emrat e tyre, ndoshta u ngjallin kujtime të hershme, me plot nostalgji të raporteve tona: mësues me ata, të kohës së vështirë që kemi mbaruar shkollën bashke, ose në periudha të afërta, me Prele e Pahka Shytanin, Luigj e Gjyste Shytin, Ndoc e Drande Odrin, Martin e Delina Arrën, Leze Plepin, Marash Gjonin, Zef Token, Dede Preken, Marije Musen, Pashko e Zoge Arën, Syke Çarkun, Marije Gilaj, Gjoke Verrishtën, Zef Barin e Mark Gjonin. Pjesa më madhe prej tyre kanë qenë në periudha të ndryshme kohore edhe drejtues shumë të suksesshëm të shkollave dhe me përvojën e gjatë të punës kanë dhënë ndihmese të madhe në formimin e mësuesve të rinj, të cilët u janë shumë mirënjohës atyre Natyrisht nuk mund të rrinim pa kujtuar me shumë nostalgji dhe dhimbje shokë e kolege që i kemi humbur gjatës dhe kane ndërruar jete, por për ne ishin të pranishëm në kujtimet tona, por edhe të gjithë popullit të krahinave e fshatrave të zonës sonë, ku ata shkrinë gjithë energjitë e dijet e tyre në shkollimin e brezave të tërë dhe lanë gjurmë të pashlyeshme në arritjet e padiskutueshme në fushën e shkollimit në të gjitha vendet ku punuan

Kujtuam mësuesit dhe drejtuesit: Age Gjokë Marku, Dedë Mbrapshtia, Fran Beka, Fran Dardha, Frano Gjellaj, Gjergj Kola, Gjergj Kroni, Gjin Avdia, Gjin Lekë Preka, Gjokë Pjeter Marku, Lazer Fusha, Lenë Qetaj, Marash Miruku, Mhill Leka, Mhill Mark Milani, Mhill Mici, Mira Kokerrja, Mira Çarku, Mirash Binoshi, Mirash Zef Preka, Ndoc Marash Nohëni, Ndoc Prend Kacoli, Ndoc Xhuri, Ndue Gjokë Bregu, Ndue Kroni, Ndue Ndreza, Ndue Pjeter Marku, Ndue Vatë Gjellaj, Ndue Çuni, Pal Mirashi, Pjeter Kolë Dretni, Pjeter Selimi, Pllumb Lulash Vuksani, Prekën Simoni, Prekë Sokoli, Prelë Bregu,

Prenda Lekçaj Çeli, Sokol Marashi, Shaqe Zog Sokoli, Shkurte Rushetë Ara, Terzina Gjellaj, Vatë Brraka, Violeta Dardha, Zef Delia, Zef Gjellash Fierza, Zoga Lekçaj, Drane Kroni, Gjeto Çezmja, Kolë Funiçi, Lulash Ndoc Gilaj, Martin Dedë Çetina, Mirash Zef Ndreza, Ndoc Grimaj, Pal Rupa, Prelë Grimaj, Zef Fusha, Zef Livadhë dhe disa të tjerë, që sot nuk ndodhen më fizikisht në mes ndesh, por emri e vepër e tyre ruhet e përjetshme në kujtesën

e arritjet e padiskutueshme të shkollës të atyre viteve, që pa dyshim ishin shumë të mëdha.

Ne, vërtete na quanin “komisare të dritës” dhe pranojmë me kënaqësi këtë përcaktim, se vërtetë ne çuam dritë përmes dijes dhe pavarësisht vështirësive, që na shkaktonte ndonjëherë politizimi i tepërt i teksteve, i përmbytjes dhe metodës së mësimit dhe asnjëherë nuk e patëm atë qellim, por përparësi i jepnim dijeve

misioni i shkollës ka ndryshuar, duke çua në ndryshimin e këtyre raporteve, të rolit të mësuesit dhe të mësimit me nxënësit.

Synimi kryesor i shkollës, qendër shekuj ka qenë mësimi dhe edukimi, sot po shndërrohet në misionin, që të formohen njerëz të “suksesshëm” me çdo mënyrë e mjet pa skrupuj moral, dhe vetmja vlerë e njeriut matet me shkallen e pasurimit të tij. Vlerat morale kane rene, shkolla është



popullore model përkushtimi ndaj kauzës së shkollimit popullor në krahinat e fshatrave të zonës sonë. Pjesën më të madhe të punës sonë, me brezin tonë na takoj ta zhvillojmë në një sistem, që pavarësisht nga ato që thuhet për punën dhe figurën e mësuesit e vlerësojnë shumë dhe përpjekje ta stimulonte me të gjitha mënyrat, t'i siguronte atij kushtet më minimale të jetës për strehim, ushqim, pajisje me baze material didaktike më të nevojshme në infrastrukturën shkollë dhe të tjera, duke ndërtuar shkollë në çdo fshat, fillimisht 8-vjecare e më vonë edhe të mesme të përgjithshme e profesionale, që u hapën dhe që bënë të mundur me qindra nxënës të vijonin më vonë shkollimin e lartë në dege të ndryshme.

Nihilistet, që përpiqen të zhbëjnë gjithçka nga sistemi i kaluar, duke thënë, se ne, mësuesit ishim të politizuar dhe përçonim tek brezi i ri ideologjinë e kohës, por e marrin përgjigjen tek rezultatet

shkencore dhe edukimit të një morali të shëndoshtë tek brezi i ri.

Ne, na mungonte teknologjia e sotme, por me bazën didaktike, që krijonim vete, me bibliotekat në çdo shkollë, me laboratorët dhe bazën prodhuese e eksperimentet në shkollat bujqësore, me terrenet sportive me mjetet më të domosdoshme e shndërruam shkollën në një kantier pune, në të cilën nxënësit ndienin kënaqësi të ishin aty dhe ku populli kishte besim të plotë tek shkolla dhe mësimi mësuesit sa që mësuesit ishin të paret që merrnin pjesë në të gjitha gëzimet, dasmat apo në ngjarjet historike të fshatit.

Lidhur me funksionimin edukues të shkollës në atë kohe flasin më mirë shifrat zero të kriminalitetit të rinjve në atë periudhë, ku raportet nxënës – mësues – prindër ishin mese të shkëlqyera dhe marrëdhëniet tejet frytdhënëse.

Në kushtet e reja, që u krijuan në sistemin e ri të quajtur demokratik, roli dhe

shndërruar në një vend, ku “liria” e nxënësit është gjithçka, ku misioni i mësuesit ka humbur dhe është më i parëndësishëm se një edukator tablat, ose kompjuter. Dinjiteti i tij është nëpërkëmbur sa që ai nuk ka asnjë detyrim ndaj vetes apo shoqërisë. Qofshim të gabuar, por këto politika, strategji e praktika shkollimi po degradojnë brezin e ri dhe kjo vihet re në shkallen e lartë të kiminialitetit, dëshpërimet e braktisjes së vlerave morale e shoqërore të krijuar nder shekuj përmes punës së shkollës, familjes e shoqërisë.

Kjo është një temë e gjere diskutimi, e cila nuk është objekti i këtij shkrimi, por që zuri vend në bisedat tona, në takimin tonë dhe që pavarësisht moshës sonë janë probleme që na shqetësojnë, sepse kemi edhe ne nipër e mbesa, por jo vetëm ato/ata, që po vuajnë pasojat e këtij sistemi arsimor, ku më rendësi i jepet edukimit seksual, se edukimi me norma qytetare e morale. Por këto shqetësime, të cilat zunë vend në diskutimet tona, në këtë takim nuk zbehen aspak natyrën e këtij takimi dhe kënaqësinë që na dhuroi ai.

U ndiem krenar që kemi qenë misionar të asaj armate të madhe mësuesish, që kontribuam në shkollimin e përkatës të dijeve nder breza!

U jemi mirënjohës popullit e prindërve, që na besuan e vlerësuan pasurinë më të madhe të tyre, fëmijët, që na mbështeten e vlerësuan, duke shpresuar për më të mirën e ditëve që do vijojnë.

U ndamë me shpresën se përsëri do të festojmë bashke edhe 7-Mars të tilla, kështu bashkë e gjithmonë aktive në punë edhe në ide për më mirë!

Mirënjohje organizatoreve të takimit z. Luigj Shyti e Prele Shytani!



Mësuesi, Misionar i dijes dhe i procesit shoqërorë

Shkolla, si tempull i dijes, i mëson njeriut shumë gjëra të vlefshme në jetë, që përmes të mësuarit, njeriu mëson si të sillet në shkollë, familje e shoqëri. Edukimi në shkollë, i përgatit nxënësit të bëhen qytetarë të mirë e të aftë për jetën, të edukon vlera e të zhvillon aftësi për jetën. Këtë detyrë, përgjegjësi dhe mision fisnik e ka mësuesi në punën me nxënësit, si përçues i dijeve dhe i idealeve më fisnike në breza dhe i së resë përparimtare në tempullin e dijes siç është shkolla.

Të jesh mësues, edukator është detyrë e vështirë, përgjegjësi profesionale, por edhe fisnike, si përçues i dijes ndër breza.

7 Marsi, është evokim dhe ditë e shënuar për ta, kujtim mes brezash, ato vite të paharruara si mësues edhe kolegë, si stafetë brezash, kujtime e nostalgji edhe

me tufa të luleve, dhe urimet e përzemërta nga nxënësit e tyre për mësuesit e dashur si respekt dhe mirënjohje për ta dhe punën e tyre në edukimin e tyre. Ashtu siç porosiste i madhi At' Gjergj Fishta: "Mësuesia, asht zeje e shejtnueme", pasi e ardhmja e një kombi, përparimi i një shoqërie varet nga shkolla dhe puna e mësuesve, nga dijet që u japin brezave. Në Ditën e Mësuesit, shkolla 9 vjeçare "Gjergj Kastrioti" në qytetin e Lezhës, me drejtoreshën e palodhur dhe vizionare, znj. Dije Zefi, bashkë me mësuesit dhe nxënësit, me praninë edhe të prindërve të tyre, kanë festuar me një koncert të bukur e të larmishëm artistik me interpretimet e bukura nga nxënësit e kësaj shkolle, të veshur edhe me kostume tradicionale, duke krijuar një atmosferë të gëzueshme e festive.



Mësuesit dhe nxënësit në këtë ditë të shënuar për ta, i ka përshëndetur dhe uruar për punën profesionale dhe fisnike në punën me nxënësit, drejtoresha e kësaj shkolle me emër dhe rezultate në shkolim, znj. Dije Zefi, si iniciatorë e promovuese e këtyre veprimtarive dhe këtyre vlerave, duke evokuar 7 Marsin e vitit 1887, shkollën e parë shqipe dhe rolin e patriotëve shqiptarë në këtë mision fisnik

dhe atdhetar për shkollën e gjuhën shqipe, duke e vlerësuar punën e mësuesit si misionar të dijes e të edukimit të brezave, si mision fisnik e vlerë kombëtare.

E ardhmja e një kombi e përparimi i një shoqërie, varet nga shkolla dhe puna e mësuesve, nga dijet dhe edukimi që u japin brezave.

JAK RROZHANI

Reformat e arsimit kanë mbetur në letër?!

Frederik Vilhelm: "Shkolla vlen aq sa vlen edhe mësuesi".



Fran Gjoka, Lezhë



Mevlud Buc, Dibër

Reformimi i shkollës është një sistem shumplanesh dhe rezultat i bashkëndikimit dhe bashkëpunimit të shumë faktorëve e aktorëve, jep ndikimin e tij në harmonizimin e mirë të faktorëve që ndikojnë drejtpërsëdrejti në reformën e nisur, e cila do të bënte të mundur që të funksiononte më së miri mekanizmi i drejtimit dhe i menaxhimit subjektiv të arsimit. Arsimit nuk është një përgjithshëm subjektive që kanë mbetur në letër, por një projekt inteligjent që kërkon një menaxhim intelektual në rang qarqesh dhe rrethesh të vendit.

Militantizmi e ka dëmtuar rëndë sistemin e arsimit të vendit

Jo kushdo mund të bëhet drejtues, paravarsisht nga vullneti e dëshira e mirë e njerit apo tjetrit. Parë në këtë këndvështrim, mendojmë se militantizmi e ka dëmtuar rëndë sistemin e arsimit të vendit. Përzgjedhja e kuadrit drejtues të arsimit, i thëncin me konkurs, por që kanë vepruar ndryshe, duke i emëruar drejtuesit mbi bazën e kriterëve të tjera si ato nepolitike, partiake e, pse jo, edhe korruptive e servile, e kanë kompromentuar rëndë real-

izimin e reformës, duke krijuar mendimin e gabuar se drejtor arsimit dhe, për më tepër, drejtor shkolle, mund të bëhet kushdo. Në këtë kuptim është paradoksale dhe i ofrohet një shërbim i keq institucionit të arsimit dhe të ardhmes së tij, kur drejtori, "që ka fituar" të ashtuquajturin konkurs, ka më pak arsim dhe përgatitje shkencore e pedagogjike sesa kolegët e tjerë. "Meritat" e tij ai le t'i shfaqë në një vend pune tjetër, por kurrsesi në fushën e arsimit, këtë sektor delikat, prioritar dhe shumë të ndjeshëm për shoqërinë dhe të ardhmen e saj.

Është shkruar e folur shumë për rolin e drejtorit apo zv/drejtorit të shkollës (ky i dyti, çelësi i shkollës autori MB), fare pak ose aspak nuk i është kushtuar rëndësi parësore nga DAR, ZA apo përse jo nga vetë Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Pra, flitet e flitet, bëhen seminare e jepen receta shabllone dhe përsëri "në qafë" të kolektivave, vihen drejtues formal ose ekstremistë të maturuar se sa "socialistë" apo "demokratë" janë. Sigurisht, që diplomimi, specializimi, gradat a titujt kanë vlera të rëndësishme, por në drejtim të shkollës nuk është takti, mjeshtëria, drejtësia, përkushtimi dhe reformimi atëherë ata që janë fituar dhe emërimi që bëhet dalin kanceroze, ku më shumë dëmtohet se sa ecët përpara. Sa i drejtë, sa punëtor dhe veprimtar e organizator është drejtori? Pasqyra e këtyre janë kolektivi pedagogjik, nxënësit e qeveria dhe komuniteti prindëror. Ky trinom është syri

i përditshëm, është rojtari më vigjilent që maturon "gradat", "diplomat" e mbi të gjitha efektivitetin praktik dhe drejtësinë e atyre që bëjnë emërimet. Vërtetë e fiton "konkursin", mund të paraqesë dëshmi kualifikuese, ai bëhet drejtues shkolle, por nëse nuk e ka parësore shembullin si mjeshtër i mësimdhënies, si ndihmës e dashamirës me mësuesit, i thjeshtë, këshillues dhe mbi të gjitha i prerë, bazuar në rregullore, atdhetar, "shkundet" liberalizmi dhe konformizmi pedagogjik. Faktet e realitetit bashkëkohor dëshmojnë se ndërhyrjet partiake e kanë dëmtuar shumë cilësinë e drejtimit të shkollës e pse jo edhe atë të stafeve drejtuese në DAR.

Të mos lëmë mënjani si gjoja të pavlefshme përvojat në arsim

Pa rënë në arkaizëm, por për hir të së vërtetës, e dimë të gjithë se ish-drejtuësit dhe mësuesit tanë, por dhe prindërit tanë, nuk kanë patur këtë shkollim, specializim, a kushte si në kohët e sotme, por sedra, edukata, fjala e shembulli i tyre mbetën një testament i zbatimit praktik të edukimit. Nëse një nënë u flet fëmijëve kundër babait të tyre, apo kundër kushërinjve a fqinjëve, i shndërron fëmijët në ziliqarë, egoistë, të cilët fitojnë në gen urrejtjen e përbuzjen ndaj të tjerëve, madje edhe hipokrit edhe vrasar. Sot më shumë se kurrë është e arsyeshme të njihen në rrënjë traditat e vyera arsimore, përvojat e vjetra dhe të reja, të vetëveprohet me takt, me shpirt, me maturi e guxim duke rrezatuar në praktikë zotësitë, duke bërë që pema e diturisë të blerojë, që në mjedisin e komunitetit të krasiten dukuritë negative. Sa e si komunikon drejtori a zv/drejtori? Sa autoritet ka në shkolle dhe jashtë saj? Sa rrezaton si udhëheqës

i veprimtarive? Mbi të gjitha sa i drejtë e reformues, sa u jep dritë vlerave në kolektiv e komunitet? Drejtimi është art, por sa artist është drejtori?

Nisur nga përvoja shumëvjeçare e punës tonë në arsim e drejtim, mendojmë se mësuesit bashkëkohorë sot fare pak e njohin e studiojnë psikologjinë dhe traditat komunitare. Vërtetë ka klasa me shumë apo me pak nxënës, por në këto mbetet që të ngulmohet me shpirt krijues për t'i mësuar dhe edukuar që të brumosen të dashur e dëgjues të prindërve, me respekt e nderim për njëri-tjetrin, për fqinjët, për vendlindjen a mjedisin ku banojnë. Njohja e vlerave dhe e traditave e bën nxënësin të jetë i sjellshëm, kokulur ndaj dijes, fëmijët t'i shmangin emisionet amorale të internetit. Sot drejtuesit e mësuesit, e mbi të gjitha prindërit, janë në fushëbetë të re për edukimin larg fjalëve boshe e klisheve pa bukë. Në fshat a në lagje të qyteteve jo vetëm fëmijët, por në shumë raste gjen plot që nuk njohin e pasqyrojnë traditat atdhetare, luftarake, zakonet e mira, figurat e shquara, historikun familjar e më gjerë. "Një shembull në praktikë, - shkruan filozofi Sami Frashëri, - vlen më shumë se një mijë fjalë të bukura". Është fakt se në situatën e re gjen mësues e drejtues të tulatur, pa guxim e maturi, Përse? Nën pretekstin se të mos bëj "dhunë". Zgjedh liberalizmin ose në disa raste bajraktarizmin, ku ky i dyti shpërfaq kryeneçësinë, kamuflimin e formalizmin. Përse? Ngaqë përzgjedhja me portal në dukje është i mirë, i arrirë, por drejtuesi e mësuesi janë në provë të përditshme përpara punëve që dalin me mendje krijuese, vetëveprim, studim e fryte konkrete. Pra, nuk mjafton vetëm ta mbjellësh arën, të hedhësh farën, por të ecësh me korrektësi



në drejtim të shërbimeve në vijimësi që të korrësh frytet e duhura. Të jemi realist, ta themi troç: Mungon mendimi krijues, shpirti human e pasionant me qëllim që drejtuesi, mësuesi e prindi të jenë në veprim ditor, bashkëkohor, me shembull, me takt, me durim e me fjalë të peshuara, duke maturuar në vijimësi ecurinë e fëmijës. Është e ditës, e udhës, domosdoshmëri: Reformimi, përkushtimi dhe zbatimimi që emri i sistemit arsimor të dritësojë, që shpirti të dritësojë nëpërmjet dashurisë së nxënësve për dijet për njëri-tjetrin, për mësuesit, për familjen e traditat komunitare e më gjerë. Konceptet si “është fëmijë i padurueshëm e nuk bindet”, “hë, se kanë faji familja apo e ka shkolla” kësaj i thonë të shkatërrosh bucelat, të mbetesh në plan konstatimesh pra, si i thonë vetëm t’i heqësh lëkurën arës, ndërkohë që prodhimet i merr kur punohet qilizmë. Është koha të luftohet në mënyrë ballore formalizmi në mësim dhe edukim, në veprimtari, në punën e diferencuar- sigurisht dominant është drejtori, por dhe mësuesi e prindi. Kërkohet konceptim i ri, veprime konkrete ku për të rritur emrin e sistemit arsimor do rritur shpirti veprues, reformimi i përditshëm drejtues-mësues-prind; trinomi themelor reformim, përkushtim, veprimtari ku të demonstrohen arritje mësimore edhe edukative të dukshme, cilësore e të prekshme.

Jo formalizëm, por rezultate konkrete në përvetësimin e dijeve

Të shqetëson fakti se në mesin e vitit shkollor MAS bën ndryshime, duke ndryshuar strukturën e orëve dhe lëndëve mësimore. Pra, tre lëndë të ndryshme në një ditë, nga gjashtë lëndë që bëheshin. Kjo demagogji afatshkurtër e peshës së çantës së lehtë do të zëvendësohet ngadalë me dije të cinguara të nxënësve. Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë e përligj me faktin se s’kemi shkollë e kushte minimale të domosdoshme për punë në shumë fshatra e qytete të vendit, prindërit s’kanë patur ndonjë informacion paraprak për orët e ndryshuara, kuadrin ligjor.

I ashtuquajtur portal “Mësues për Shqipërinë”, është huazuar në formën më të shëmtuar në arsimin tonë. Është paradok

i vërtetë praktikimi i kësaj formule abstrakte, kur në Itali dhe vende të tjera evropiane bazohet në meritë dhe është i vërtetë e kuptimplotë. Për Italinë, mësuesit shkojnë ku ka nevojë vendi, sepse motivohen dhe u krijohen kushte optimale për punë dhe jetesë. E kundërta ndodh në sistemin tonë arsimor. Ky është portal që po shërben si fasadë djallëzore e MAS dhe Drejtorive Rajonale e ZA-ve, për të mbuluar korrupsionin në këto drejtori të vendit, që si pasojë sjell një paligjshmëri të vërtetë që po bëhet me emërimet dhe shkarkimet e mësuesve. Vazhdojmë me metodën alla shqiptarçe. Me të drejtë Frederik Vilhelm thoshte “Shkolla vlen aq sa vlen edhe mësuesi”. E kemi thënë edhe herë të tjera se kemi drejtorë shkollash që po e shkatërrojnë sistemin tone arsimor, që nuk i shërbejnë vendit të punës, që janë nën nivelin e formimit shkencor – pedagogjik dhe profesional të mësuesisë në shkolla.

Me keqardhje shikojmë aty-këtu një liberalizim të theksuar të veprimtarisë mësimore dhe edukative të punës në shkollat shtetërore, ndryshe ndodh në shkollat jopublike, ku zotëron rregulli dhe disiplina janë në kuota optimale. Në shkollat publike mungon kërkesa unike e llogarisë ndaj nxënësit, ku mësuesi e sidomos nxënësi, fillon e mbaron ditën e mësimit duke lëvizur sa andej këtej dhe, më keq akoma, duke e lënë vetëm klasën e tij në kujdestari. Në pikun e punës së ditës mësimore grupe mësuesish i gjen kafeneve, të ulur për shtatë palë qejfe, madje shpesh, bashkë me drejtuesin, ndaj ndodhin dhe ngjarje të pakëndshme në shkollat tona. Kemi drejtues shkollash që kanë mbi 25 – 30 vjet në drejtim dhe janë kthyer si feudalë, apo pronarë në shkollat e tyre. Ka ardhur koha të kemi një leadership të formuar në mënyrë të plotë, kundër konformist e racional, që me kurajë civile dhe guxim intelektual pranon se ky sistem arsimor duhet ndryshuar, të gjenerojë intelekt e qytetari, duke iu larguar “leadershipit të tenderëve e bandave” të të gjitha niveleve që ka kapur për fyti sot shumë drejtorë qarqesh dhe të ZA-ve të vendit.

Fatkeqësisht, sot kemi drejtorë qarqesh dhe të ZA-ve të vendit që kanë hyrë në vi-

tin e gjashtë të drejtimit. Kjo stërzgjatje e pasuksesshme në drejtimin e arsimit ka dhënë mundësinë e pasurimit të tyre përmes emërimeve pa kriter. Kemi plot raste të vërtetuara, për veprime abuzive dhe korruptive, nga media e shkruar dhe ajo vizive. Me sa vëmë re, MASR nuk e ka pikën e impenjimit për të parë nëse është e domosdoshme një ndërhyrje e tillë në reformimin e kuadrin drejtues në të gjitha nivelet në arsimin tonë. Si në çdo institucion tjetër, edhe administrata rajonale e arsimit ka nevojë urgjente për një reformim total të saj.

Mendoj se duhet të vendosen në krye të arsimit rajonal, apo të ZA – ve drejtues që kanë guxim intelektual, persona apolitike dhe që janë kundër konformizmit, të jenë racional dhe të realizojnë dy synime të mëdha: aktin e pastrimit dhe të ndryshimit në administratën publike të arsimit.

Nga ana tjetër, nuk ka një sistem të vlerësimit të performancës të punonjësve në nivel DAR dhe ZA-ve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore vartëse, gjë e cila le për të dëshiruar.

Sado të flasim, përsëri është politika që po e shkatërron arsimin

Në çdo drejtori qarku apo dhe të ZA-ve të arsimit ka specialistë, që fatkeqësisht janë kthyer vetëm në zbatues të shkresave dhe vendimeve burokratike që vijnë nga lart dhe që në shkollë pak ose aspak shkojnë. Çdo gjë ka mbetur vetëm në besimin absolut të drejtuesve të shkollave, ndërsa me mësuesin, vështirësitë e punës së tij, nuk merret askush. Fatkeqësisht u hoq kontrolli i inspektoratit rajonal të arsimit. Mendoj se ishte një gabim i rëndë për MAS. Shpresoj të rikthehet, sepse drejtuesit e shkollave dhe mësuesit do të jenë më impenjativ për punën e tyre mësimore.

Sado të flasim, përsëri është politika që po e shkatërron sistemin arsimor, sepse simpatizantët po e mbajnë gjallë politikën e ditës në arsim. Ka ardhur koha që drejtorët e arsimit duhet të largohen, duke sjellë prurje të reja në drejtimin e arsimit në qarqet dhe rrethet e vendit. Vetëm kështu i bëjmë nder shkollës dhe komunitetit arsimdashës. Vetëm kur të heqim dorë nga preferencat politike dhe serviliz-

mat në punën me kuadrin në arsim dhe të orientohemi vetëm nga ana profesionale, do të garantojmë disi realizimin me sukses të reformës dhe plotësimin e standardeve në arsim.

Ç’po ndodh me tekstet shkollore?

Është folur dhe shkruar për ngarkesën mësimore të mësuesit, për libra të mbingarkuar me material pa vlerë, për asimilim të vështirë të marrjes së njohurive nga nxënësit, për peshën e rëndë të çantës etj. Çfarë po ndodh me tekstet shkollore, ku janë vlerat intelektuale kombëtare që përçohen me anë të tyre? Po bota akademike pse është mënjeluar në mënyrën më të qëllimshme dhe më dashakeqëse përballë këtyre fakteve që na shqetësojnë? Vazhdojmë të kopjojmë librat e vendeve të tjera të botës, kur kemi programet tona mësimore, të cilat mund të përshtaten fare mirë, duke ruajtur kulturën, pavarësinë dhe vlerat tona të çmuara kombëtare.

Fatkeqësisht, sot lloj-lloj shoqatash po futen çdo ditë në shkollat tona, pa dijeninë e autoriteteve dhe komunitetit prindëror, duke aplikuar programe që i kanë fituar në tendera të ndryshëm, madje shpesh, duke cenuar edhe programin mësimor.

Ajo që është më e turpshme, përmes një ankete, nxënësit nga mosha 11-15 vjeç janë pyetur për llojin e seksit që kanë kryer, anal, vaginal apo oral, duke thyer kështu çdo normë të edukatës qytetare. Dhe kjo, me justifikimin se plotësimi i formularit ishte “vullnetar” dhe nxënësit nuk ishin të detyruar t’i përgjigjeshin të gjitha pyetjeve apo se pyetësi ishte përgatitur nga ndërkombëtarët. Kështu deklaroi MAS.

Për të shkuar në rrënjë të problemit, duhet të kthehemi te qëllimi themelor i menaxhimit intelektual të arsimit që, me keqardhje, themi se askush nga drejtuesit e arsimit në qarqe dhe ato të ZA-ve e shkollave se kanë marrë ende seriozisht dhe të kenë një përgjigje se si duhet drejtuar dhe administruar në të ardhmen arsimi ynë kombëtar. Ne na duhet gjithashtu, ta shndërrojmë këtë në mesazh sensibilizimi për shkollën, që arsimi ynë të jetë sakaq i pranishëm dhe frymëzues për të ardhmen e brezit të ri.

Jeta vdes atje ku vdes pylli

Me rastin e 21 Marsit Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve

Kur hap "portën" gjigante të pyllit, një ndjesi e bukur e ëmbël të pushton. Ndjen ngadhënjim, krenari dhe madhësi...

Kur jeni në pyll, fillon pastrimi i trurit dhe i zemrës, lemë jashtë tij pasionet e këqija, zemërimin, stresin, ankthin, xhelozinë dhe përipiqemi të përjetojmë çdo moment.

Çdo gjë këtu ka jetë dhe kjo jetë të befason. Një jetë që është produkt i energjisë diellore e gjen në dru, në kurorë, në tokë dhe nën tokë. Këtu çdo qenie "ha diell", jeton nga dielli, ngrohet me diell, merr frymë nga dielli dhe i përulet magjishëm diellit.

Këtu jeta, dashuria, miqësia, bukuria, poezia, muzika, miqësia, madhështia... marrin një kuptim dhe një përmasë tjetër.

Vazhdoj rrugëtimin nën mbretërinë e drurëve, dhe magjia e tyre më shoqëron në çdo hap. Drurët nuk nxitojnë, nuk vrapojnë siç bëjnë njerëzit, ato rriten ngadalë, shumë ngadalë dhe kjo dukuri i shoqëron gjithë jetën.

Ja le të shikojmë shumëzimin dhe shtimin e tyre. Është mistike ato i marrin masat një vit më përpara. Halorët pothuaj frutifikojnë çdo vit, ndërsa fletorët kanë një programim tjetër, ato frutifikojnë 1-3 vjet.

Kur fara bie në tokë në vjeshtë, logjikisht duhet të rrënjëzojë, por nuk ndodh një gjë e tillë. Po të çelin menjëherë do të përballën me dy probleme. Ato nuk do të përballojnë ngricat e dimrit dhe do të vdesin, dhe një pjesë e madhe e tyre nuk do t'i shpëtojnë ngrënies nga kafshët. Në këtë periudhë ka mungesë të theksuar ushqimi.

Ky fenomen i përvitshëm dhe për shumë shekuj, ushtroi presion mbi fletorët. Duket sikur drurët për të mbijetuar, për t'ju përshtatur situatave dhe sfidave, filluan të merren vesh me njëri-tjetrin.

Drurët në përgjithësi i kanë të dyja llojet e luleve, si femërore dhe ato mashkullore. Për përmirësimin e racës së tyre, përmirësimin dhe evoluimin e llojit, që të durojnë më mirë sfidat, nuk duan që të pllenohen me lulet e të njëjtit lloj, dhe me ato që ndodhen shumë pranë. Jo vetëm nuk duan, por janë programuar dhe këmbëngulin që ta pengojnë një gjë të tillë. Ato nuk i çelin përnjëherësh të dy llojet e luleve, por ruajnë një interval kohor midis tyre. Vetë rrugëtimi në miliona vite i ka detyruar të bëjnë një veprim të tillë. Drurët që pllenohen me lulet e të njëjtit lloj, ose me drurët shumë pranë, humbasin shumëllojshmërinë, cilësitë, bëhen shumë të ndjeshëm ndaj sëmundjeve dhe nuk përballojnë konkurrencën.

Drurët vërtet nuk kanë tru, por të befason ruajtja e ekuilibrit dhe përlogaritjet që bëjnë në administrimin dhe shpërndarjen e fuqisë dhe energjisë së tyre. Ato i bëjnë llogaritë mirë që të plotësojnë të gjitha nevojat e tyre. Një pjesë të energjisë, të ushqimit, e përdorin për të zhvilluar trungun, degët, gjethet, rrënjët, që ato të

rriten dhe të forcohen, të mbajnë peshën e borës, t'i rezistojnë forcës së erës, të përballojnë konkurrencën ... Druri mendon për çdo gjë të tij që t'i ushqejë dhe ato të gjitha së bashku, e ndihmojnë drurin që të ngopet me ajër, të marrë frymë lirisht, dhe procesi i fotosintezës të bëhet në mënyrë perfekte.

Një pjesë të rezervave i mban dhe i përdor në momentet e vështira, për të përballuar sulmet e armiqve. Ato i mbajnë dhe i ushqejnë mirë ushtarët mbrojtës, insekticidet, aromat, enzimat, taninin ... Një ushtri e stërvitur dhe e ushqyer mirë, është në gjendje që të përballë me çdo situatë.

Në fund çfarë mbetet nga rezervat ushqimore, druri i përdor për riprodhimin e tij. Në momentin kur lulëzojnë pllenohen dhe janë në orgji, siç çdo qenie e gjallë e humbasin vigjilencën ndaj sulmeve të armiqve. Në çdo moment ekzistojnë insekte, bakterie, kërpudha që presin për të goditur atje ku hallka e zinxhirit është më e dobët.

Në fazën e lulëzimit, pllenimit, në se druri sulmohet dhe rrezikon jetën e tij, ai nuk e ndalon këtë proces magjik që të merret me armiqtë, ai është i vendosur që të sigurojë vijimësinë.

Ja shikoni këtë lis gjigant mbi 30 metra lartësi. Gjatë gjithë jetës së tij mbi 400-vjeçare, do të prodhojë me miliona fara (lëndë), dhe vetëm njëra prej tyre do të ketë fatin që ta zëvendësojë. Të gjitha të tjerat tashmë e dinë fatin e tyre, do t'i hanë kafshët, shpendët, ose do të bëhen humus dhe ushqim për të ndihmuar farën e vetme që do të sigurojë vijimësinë.

Kur nga mosha e tejpjekur rrëzohet dhe vdes druri mëmë, bijat që ndodhen poshtë saj pësojnë shok. Ato njësoj si njerëzit kur humbasin njeriun e tyre të shtrenjtë, çorientohen, alarmohen dhe vriten shpirtërisht nga humbja ... Duan kohë që të rimarrin veten dhe të përshtaten pa ndihmën e nënës, duan të paktën 3-10 vjet.

Më tërheq vëmendjen një ah që ka mbirë poshtë pishës dhe i ka dalë asaj sipër, duke e nënshtruar atë plotësisht. Kur një zog e merr farën e ahut dhe e fsheh atë në rrënjët e pishës, kjo farë në pranverë rrënjëzon dhe rritet pa zhurmë. Rrënjët e ahut futen në zgavrat e rrënjëve të pishës dhe në mjediset e lira, thithin rezervat ushqimore që i nevojiten. Kështu ai zhvillohet shpejt dhe në disa vite pushton hapësirën dhe krejt pishën. Karakteristikat biologjike të ahut, e bëjnë që ai të

jetë i veçantë dhe i pakonkurueshëm nga llojet e tjera. Pisha mund të vijojë kështu për disa vite, duke luftuar për të mbrojtur shtëpinë e saj, por në fund do të dorëzohet. Në mjedise pyjore, në bashkësi dhe në habitatin e tij, ahu është ai që bën ligjin dhe i nënshtron të gjitha llojet, ndërsa në

dhe miliardat e qelizave të trupit, zemra dhe shpirti, nuk duhet të gjenden në kohën e shkuar, as në të ardhmen, ato duhet të përjetojnë momentin, të tashmen.

E admiroj pyllin, ai nuk është i zhurmshëm dhe i mërziqshëm si qyteti, nuk është i ndotur, ai është i heshtur, me një

heshtje magjike, një heshtje që shpalos dhe të tregon shumë gjëra. Për ta zbuluar më mirë edhe lëvizja jonë duhet t'i bashkohet kësaj heshtjeje, kësaj harmonie, këtij ritmi, kësaj muzike dhe poezie.

Ne pylltarët shumë herë në pyll, nuk ndjekim ku na shpie shtegu, rruga ... Për ta kontrolluar dhe monitoruar me mirë, krijojmë shtigje dhe monopate të reja, të pashkelura, të vështira.

Pylli i ngjan një supermarketi gjigant natyror, tejet i pasur dhe i mbushur me prodhime e rezerva. Këtu gjen gjithçka, gjen lëndën e drurit, drutë e zjarrit, qymyrin, kafshët, shpendët, farat, frutat, gjen ujë, mjalting, bimët mjekësore, gjen ajrin e pastër, gjen lulet, kërpudhat, peizazhin ... Është një thesar i vërtetë ku shumica e tij ndodhet i kyçur me dry, për ta marrë duhet gjetur çelësi magjik, çelësi që nuk lëndon, që nuk vret, duhet gjetur çelësi i vërtetë dhe jo ai kopil, duhen gjetur njerëzit e duhur, pylltarët e pa-

sionuar, të përgjegjshëm që dinë t'i përdorin këto thesare dhe dinë të administrojnë këto thesare.

Po largohem sot nga pylli, largohem për të qëndruar gjithë jetën pranë tij. Ka shumë mënyra për të hyrë dhe komunikuar me të, ka shumë porta, shumë drejtime për t'u futur, por vetëm një rrugë dhe një mundësi të vetme për të qëndruar gjithmonë pranë tij. Ajo është dashuria, respekti dhe nënshtrimi ndaj ligjësisë të tij, është bashkëpunimi dhe dëgjimi i zërit dhe i simfonisë së Tij.

Duke e përshëndetur për t'u riparë shumë shpejt, me vjen ndërmend pylltari pasionant Adalbert Stifter që tha: "Pylli është fati ynë! Mbrojtja dhe përkujdesja për të do të thotë: T'i shërbesh jetës. Jeta vdes atje ku vdes pylli!"

GJERGJ NIKA



“Ku del Kiri” natyrë magjepsë me shtegtime të panjohura ekoturistike

Ka më shumë se një vit që lugina e Kirit dhe rruga e Dukagjinit kanë marrë një vëmendje të madhe jo vetëm mediatike, por dhe me veprimtari drejtpërdrejt në terren. Është rruga automobilistike në luginën e Kirit në ndërtim që do lidhet me Breg-Lumin e Shalës, duke kaluar nëpër fshatrat e Shoshit, që ka zgjuar interesat të veçantë, shpresë të banorëve të zonës Dukagjinit për të mund të investuar në kthim dhe në rindërtim të shtëpive, për ti kthyer në vendbanime sezonale, por dhe të përhershme si para viteve 2000, për ti kthyer në bujtina pritëse të turistëve vendas dhe të huaj.

Krahinat e tjera të Dukagjinit (Pulti dhe Shoshi) kanë shembull për të “kopjuar” siç është Thethi, para vitit 2010, me gishtat e njëres dore numëroreshin shtëpitë bujtina. Po sot, sa janë? Sot me mijëra turistë vendas dhe të huaj tashmë në çdo ditë të vitit shtegtojnë në bjeshkët e Thethit, Ndërlyesës dhe Kaprrësë, e të tjera dhe të tjerë që shtegtojnë për në Valbonë. Ajo zonë është rreth 100 km larg Shkodrës, por rruga auto e ka bërë të mundur zhvillimin e ekoturizmit tashmë gjithëvjetor. Në Theth deri në Ndërlyesë sot mund të ketë rreth 2000 shtretër dhe shumë bujtina që presin turistë. Janë disa dhjetëra vetë të punësuar në shërbim të turizmit, i cili pritet të rritet akoma më shumë.

Lugina e Kirit me gjithë pasuritë e saj natyrore, kulturore dhe njerëzore, tashmë me rrugën auto mund të konsiderohet një ndër mjediset ekoturistike më të pëlqyera në Shqipëri, deri tani pak e njohur. Lugina e Kirit mund të konsiderohet “Zbulimi ekoturistik 2024”. Të gjithë ata që e njohin këtë zonë, duhet të shkruajnë dhe ta promovojnë sa më shumë këtë luginë që të konsiderohet e tillë.

Disa të dhëna shkurt për luginën dhe lumin Kir, në pjesën e sipërme të bazenit: Lumi i Kirit ka një gjatësi prej 52 km, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës afro 261 km² dhe pjerrësia e shtratit 27 m/km. Në pjesën e sipërme e bazenit shtrihen fshatrat e Njësisë Administrative Pult (Plan, Gjuraj, Mëgullë, Pog, Khan, Kir, Bruçaj (Suma), e të tjerë). ndërsa në pjesën e poshtme fshatra të Njësisë Administrative Postribë (Prekal, Ura e Shtrenjtë, Rresëk, e të tjerë). Lumi Kir, buron nga rrëza jugore e majës së Elbunit në vendin e quajtur Ndërkirsa të fshatit Plan, burime të tjera janë “Ku del Kiri”, Gurra e Thanit, Gurrat e Bajve, Plani Madh, e të tjera, pasi bashkohen këto në pjesën fundore të fshatit Plan deri në Boks marrin emrin e bregu i Kirit. Në këtë hapësirë formohen disa ujëvara dhe puse të thellë me ujë kristal. Në vijim kjo rrjedhë bashkohet me Sheun e Gjurajve që vjen nga dy degëzime, me drejtim jug ku i bashkohet Përroi i Zabelit (i cili formohet nga Sheu i Kujës dhe Përroi i Arsavë) lumi

vijon përsëri drejt jugut, ku i bashkohet përroi Mëgërrit Kirit, në vijim i bashkohet përroi i Shkurtit të Xhanit, në vazhdim i bashkohet përroi Marknonajve të Kirit. Lumi Kir hyn në sektorin, që quhet Karma e Kirit, për të vijuar në këtë luginë të ngushtë ku i bashkohet përroi i Lika-

disi gjeografik ku fillon lumi Kir është nga Balëzat e Shoshit, mali i Boshit, kulmon me majën e Elbunit, bjeshkët e Planit dhe të Gjurajve deri tek qafa e Mëgullës. Është ky mjedis që ka gjithçka natyrore thajse të virgjër.

Nëse rruga auto e Dukagjinit deri në

rkullim e rrugës Planit është shenjë e mirë dhe vlerë e madhe që ai vend të mos braktiset, madje të ketë kthime dhe investime në meremetimin e kullave për ti kthyer të banueshme dhe nesër në bujtina mikpritëse. Edhe bashkia dikur do të mund të investojë në këtë rrugë, kjo lidhet me lëvizjen dhe kthimet e mundshme.

Le të përshkruajmë “hartën e parë ekoturistike” pa shumë hollësi në Plan-Gjuraj. Nëse turistët vendas apo të huaj do arrijnë në Plan, çfarë do të mund të shohin apo për ku ata mund të shtegtojnë në këmbë për në hapësira të tjera?! Ndër pikat më interesante sot është ajo që quhet Qyteza në Boksit, një objekt që duhet studiuar më thellë e pasuruar me të dhëna, por njëherazi duhen marrë masa sigurie për vizitorët. Sot ajo është e pamundur të vizitohet pasi ka vështirësi lëvizje, asnjë masë sigurie dhe shumë pak dihet për të. Aty afër Qytezës është Qereshi, vendi piktoresk ku është ngritur përmendoria e të rënëve në qëndresën ndaj pushtuesve malazez të muajit korrik të vitit 1915. Radhë mund të ketë në Shqipëri një përmendore ku janë të shënuar emrat e mbi 81 burrave dhe grave që janë varë në ato luftime nga fshati Plan, Gjuraj-Boks, Khan, Mëgullë e Toplanë dhe në gjithë Dukagjini janë vranë 106 vete. Ky vend duhet të kthehet në një pikë turistike pelegrinazhi që të vizitohet në çdo ditë të vitit. Ajo që paraqet rëndësi për fshatrat Plan – Gjurajt, janë pasuritë natyrore që lidhën më shumë vende piktoreske dhe monumente të natyrës ku përfshihen: grumbujt pyjor me rrobujt (çetinat) shekulor në lartësitë shkëmbore nga mali Elbunit deri në Bjeshkët e Gjurajve, më poshtë janë ahishtat dhe pyjet me gështenja dhe dushqe, ka shpella, burime ujore, drurë monumental dhe mrize, mullinjte e ura, vendpushimet e udhëtarëve me kryqe, e të tjera. Nga bregu i Kirit në maje të Elbunit kemi 4 katet kryesore të bimësisë me një numër shumë të madhe llojesh drunore dhe bimësi barishtore, ku rritet një faunë e shumëllojshme.

Në Gjuraj- Boks janë rreth 20 burime-kroje me emër, pranë vendbanimeve, por dhe në rrugët e lëvizjes, janë rreth 33 shpella thajse të pashkelura, madje dhe pak të njohura në ditët e sotme. Janë shumë drurë monumental kryesisht, gështenja, blinjte, arra, që kanë vlera jo vetëm si përbërës të biodiversitetit por dhe si vend shtegtime ekoturistike, e të tjera.

Në Plan, në tre lagjet e tij (Than, Prens-dreaj dhe Kujë) janë rreth 30 burime ujore të njohura dhe me ujë të pijshëm, janë rreth 20 shpella të pashkelura dhe pak të njohura sidomos nga më të rinjtë. Shumë drurë gështenje monumental me përmasa



jve, përroi i Lebriqes ku arrin në fshatin Prekal. Nga Marknonajt deri në Prekal ky sektor i luginës është pa vendbanime, por me peizazhe të papërsëritshme të veshura me bimësi pyjore dhe livadhore. Prurja mesatare vjetore e lumit Kirit është 17 m³/sek tek ura në Mes.

Pa marrë përsipër, që në këtë shkrim të ndalemi në gjithë “ofertën ekoturistike” dhe vlerat që ka e gjithë lugina nga Ura Mesit deri atje “ku Del Kiri”, po ndalemi tek ky mjedis gjeografik i fundit. Ky mjedis përfshinë fshatin Plan me lagjen Kujë, fshatin Gjuraj me lagjen Boks. Pra mje-

fshatin Pog do jetë një rrugë e asfaltuar, pra formale, rrugët auto që të çojnë në Khan apo në Plan, do jenë rrugë vendore pa standardet përkatëse përsëri me vështirësi qarkullimi. Sot udhëtohet me sakrificë dhe kemi rrugë auto deri në Plan. Tani së fundi deri në Majathanë në Gjuraj është hapë një rrugë tjetër. Këto mund të konsiderohen rrugë informale pasi këto rrugë thajse janë hapura e janë mirëmbajtur tërësisht nga banorët e atyre fshatrave, është investuar nga bijtë e atyre fshatrave në mërgim apo ata që kanë jetuar atje. Këto investime dhe mbajtja në qa-

dhe mosha shumë të mëdha gjenden në Plan dhe Kuje - Zabel. Ka dhe drurë të tjerë që kanë emra dhe gojëdhëna interesante rreth tyre, e të tjera. Në lagjen Zabel është një vend që quhet kisha Kujës, ky nuk është shkëlur aq më pak i studiuar dhe eksploruar deri sot kur gojëdhënat flasin për një kishë të vjetër dhe vendbanim që e ka qarkuar atë kishë.

Nëse ekoturistët arrijnë në Plan apo në Maja Thanës në Gjuraj me makinë (shumë shpejt dhe me biçikleta), duke bjujtur një apo më shumë netër në këto fshatra dhe duke parë shpella, burime ujore e ujëvara, drurë dhe mjedise natyrore siç u tha më lart mund të shtegtojnë nga fshati në bjeshkë, e të tjera objekte. Nga Plani mund të shtegtohet me këmbë në drejtim të luginës Shalës, duke kaluar në lagjen Kuje apo neper Gropa - Nderkisa, për në qafë Boshi, duke zbritur në fshatin Gimaj për tek Panja e Gagut dhe përfundojnë në rrugën auto Breg-Lumi - Theth. Ky shtegtim kalon nëpër shpate e qafa malesh, në peizazhe pyjore, bujqësore, hapësira urbane, e të tjera, si rrugë të njohura dhe të shkelura deri në vitet 2000 nga banorët vendas.

Një shtegtim këmbësor tjetër nga Plani apo nga Boksi është ai për në Gropë Strele, Qafa e Shtogut në Ducaj të Shkrelit, duke zbritur në rrugën auto që lidh Koplikun me Thethin. Pra, është një kalim nga luginë e Kirit në luginën e Përroit të Thatë. Kjo rrugë kalon në peizazhe shkëmbore dhe livadhe alpine dhe pastaj zbret në peizazhe pyjore e kullosore me shumë lloje drurësh dhe shkurre alpine.

Një shtegtim tjetër interesant është ai në rrugën Shtegtarëve nga Gjurajt për në

qafën e Bishkazit në Rrjoll, duke zbritur në ultësirën fushore drejt Shkodrës. Kjo ka qenë rrugë e vjetër, që dikur ka lidhë fshatrat Gimaj, Nënnavriq, Plan- Gjuraj, e të tjera, me qytetin e Shkodrës. Edhe kjo kalon në peizazhe malore shumë të bukura me fushëpamje ku duket lugina e Kirit, nga Pogu deri në Karmat e Kirit, duke peizazhet nga Kiri në Xhan, Bruçaj në Dajcë deri në Domën. Nga ky shtegtim sheh dhe bukuritë e fshatit Rrjoll, Gurrë- Kurte, Linaj, e të tjera. Në këtë rrugëtim për në Bishkaz mund të arrihet maja e Mëgullës, pika me dominante midis luginës Kirit nga ku mund të shihet thujtja e gjithë zona e Pultit në 360 gradë, shihet lugina e Kirit deri në Karma, bjeshkët e Shalës e Shoshit, mali Cukalit, malet përtej Drinit, e të tjera, madje në këtë maje janë rrënojat e disa ndërtesave, që ka dy të dhëna: E para, vend qyteze për Mgullen dhe e dyta këtu ka pas një garnizon ushtarak (poste ushtarake) të ushtrisë turke. Në afërsi të qafës së Mgulles, në anën veri-lindje të saj ka varre, që mendohet të jene varre të ushtarëve turq. Ky objekt nuk është studiuar deri më sot, që duhet sa më pare të studiohet nga arkeologet.

U ndalëm në këto tre shtegtime që dikur kanë lidh Plan-Gjurajt me hapësira kufitare dhe me qytetin e Shkodrës, janë rrugë të kalueshme, dy prej tyre thujtja gjatë gjithë vitit. Nuk duhen pajisje të veçanta, konsiderohen shtegtime me vështirësi mesatare dhe të gjitha realizohen brenda ditës dhe ato të lidhin me rrugë auto dhe zona të banuara. Janë shtegtime që ekoturisti, nuk ka nevojë të marrë ujë me vete pasi janë burimet me ujë Kristal gjatë gjithë rrugës, as të mbrohet nga dielli, se

kalon në peizazhe me pyje, e të tjera.

Në bjeshkët e Gjurajve, të Planit e të Kujës mund të zhvillohen shumë shtegtime në shtigje të tjera ekoturistike, që të ofrojnë shumë vlera me kthim brenda ditës në fshat.

Janë gjithë këto vlera natyrore në pjesën e sipërme të bazenit atje "Ku del Kiri". Këto vlera na i ofron natyra: pyje, kullota, ujëvara, shpella, drurë monumental, e të tjera. Janë këto hapësira gjeografike thujtja të virgjëra, të padëmtuara nga njeriu apo zjarret, ndryshe nga shumë hapësirat gjeografike të vendit tonë, që janë të dëmtuara nga njerëzit dhe zjarret në këto 30 vite tranzicion. Në Pult, natyra është e ruajtur ndoshta mund konsiderohet nder hapësirat model në Shqipëri.

Por, që të presim dhe përcjellim miqtë-ekoturistë, ato shtegtime që u përmendëm më sipër, të marrin jetë tashmë nga ekoturistët vendas apo të huaj, kërkohet që kullat e Plan-Gjurajve të marrin jetë. Djemtë e tyre në emigracion jashtë apo ata që janë zhvendosur drejt Shkodrës duhet ti kthejnë sytë nga vendlindja e tyre apo baballarëve. Mundësitë për një jetë më të mirë dhe atje "Ku Del Kiri" në Plan-Gjuraj në hapësirën më të skajshme të luginës së Kirit do vinë duke u përmirësuar dhe kjo brenda një kohe të shkurtër. Më i fituari është ai që kthehet i pari, ai që shfrytëzon ato vlera, ai që mirëpret turistët e parë.

Rruga automobilistike e asfaltuar nga Shkodra deri në fshatin Pog është një investim i qenësishëm më i rëndësishmi që krijon mundësi që Njësia Administrative Pult, e gjithë lugina e Kirit të marrë gjallëri dhe zhvillim. Së pari duhet tek shtëpitë, kulla e Plan-Gjurajve të jenë të pronaret

e shtëpisë, pastaj ata mund të mirëpresin miqtë-turistë. Thethin e keni afër, të mësojmë prej tyre, por dhe sa më shpejt "tua marrim miqtë-turistët". Rruga auto për në Theth mbahet e hapur, kjo në këto dy tre vitet e fundit gjatë dimrit me shumë përpjekje e vështirësi. Rruga auto në luginën e Kirit asnjë ditë nuk bllokohet nga dëbora. Kjo është një përparësi e madhe për lëvizjen e banorëve dhe për turizmin gjithëvjetor.

Nuk po ndalemi në këtë shkrim në produktet bujqësore e blegtorale, në prodhimin e gështenjave, arrave, të verës dhe rakisë tradicionale, që ofron mjedisi gjeografik i Pultit që janë të mëdha dhe shumë cilësore. Një vend konsiderohet i bekuar ku zhvillohen bletët. Mjafton të kujtojmë parqet në Pult dhe shtegtimet e bletëve nga maji deri në shtator në Kir, Pog, Xhan, e të tjera vende. Pamja dhe aroma që marrin shpatet kodrave në gjithë fshatrat e Pultit ku lulëzon gështenja, është bukuri madhështore e papërsëritshme në Shqipëri dhe jo vetëm. Fshatrat në pjesën e sipërme të bazenit të Kirit në atë që thirret me emër Pult, janë si "gjashtë petalet e një luleje gjigande" që stolisin luginën me bukuri e të veçantë në çdo stinë, me vlera dhe pasuri natyrore të mëdha.

Në mbyllje mund të themi: Krahina e Pultit me gjithçka që ofron, mund të konsiderohet si "Parajsa e ardhshme e ekoturizmit" rrëzë Alpeve dhe afër Shkodrës. Të gjithë kanë në dorë diçka, kontributi i të gjithëve është i nevojshëm dhe i domosdoshëm.

GJON FIERZA,
inxhinier Pyjesh, shkurt 2024



Sokrat i vuajtun, apo derr i kënaqun?! *



Nga Gjon BRUÇI

“Një alternativë me dy fytyra, siç janë të gjitha alternativat. Tue u krue mbas veshi, rri njeriu përpara alternativës; dy fytyra – mbrapa një fytyrë asht Sokrati i vujtun me rropatmet e veta, e mbrapa së dytës ashte derra i kënaqun me trup të rrumbullakët të vetin. Te Sokrati nuk ke çka shef: dy sytë të tretun në rrashtë, disa shkarravina të palexueshme dhe një trup me do gjymtyrë të zhatrueme e pa asnjë vijë harmonike; e te derra ke çka shef: at frotë të kombinueme mbas rregullave strikt estetike, – e sidomos që të kënaqë synin – ai trup i majmun e i shndoshë e me andje zhigatuni, dhe në fund ai bisht i përcilluem në flakën e bukurisë hyjnore. Rri njeriu përpara kësaj alternative tue u krue gjithnjë mbas veshi, ku e ha dyshimi – se nuk di se ç’fytërë të zgjedhi” . . .

Në mungesë të poetit të papërsëritshëm, po rrekem unë amatori i kësaj fushe, të mund të përshtas një copëz nga koha e sotme, që t’i afrohet disi skicës së famshme të Migjenit.

Siç dihet, Sokrati ishte profesori i filozofisë në Greqinë e lashtë. Jeta e tij pati një kalvar të çuditshëm: megjithëse zotëronte dijet dhe aftësitë e një profesori, jetoi si një plebe i varfër e madje vdiq në mjerim. Kjo ndodhi sepse ai nuk pranoi të shkelte mbi parimet e tij dhe moralin njerëzor, nuk iu jargavit pushtetit të kohës, nuk pranoi të mashtronte, por mbrojti me vendosmëri të vërtetën, ndaj dhe deri në fund të jetës ishte e mbeti i varfër, por i ndershëm.

Kanë kaluar mbi dymijë e pesëqind vjet nga ajo kohë dhe bota sot, ende vijon të përdorë postulatit retorik. “Sokrat i vuajtun, apo derr i kënaqun?” Kjo dilemë e shoqëron njeriun nga lindja gjer në vdekje. Mjaft individë pranojnë peripecitë e jetës, por kurrsesi të përkulin kurrizin përpara tjetrit, të bjerrin moralin, të pranojnë gjënjeshtrën e të mohojnë të vërtetën. Këta individë, që për fat të mirë shoqëria jonë i ka me shumicë, në konstruktin e tyre fizik e shpirtëror nuk kanë vetëm tul e dhjamë, por edhe gjak e kocka, moral e ideale të larta, të cilat, të mbujtura së bashku formojnë karakterin, vetinë më pikante të

jetës së njeriut.

Në sistemin aktual shoqëror që po ndërtojmë, ndonëse nga apologjetët e tij propagandohen liria, demokracia, shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut, shanset e barabarta, konkurrenca e ndershme, humanizmi, drejtësia e njëjtë për të gjithë etj. etj., formula tepër sinjifikative këto; në praktikën e përditshme mbizotëron individualizmi, egoizmi, lufta për pasurim me çdo mjet e mënyrë, morali sipas situatës e interesit etj. Aq më agresive janë bërë këto të fundit në periudhën tonë të stërzgatur tranzitore, ku institucionet, të cilat ruajnë e sigurojnë balancat e shoqërisë, jo vetëm nuk janë konsoliduar ende, por shpesh manipulohen e përdoren në të kundërtën e funksionit të tyre. Në këtë lloj sistemi, që përjetojmë aktualisht, jeta e individit me moral të lartë dhe ideale të pastra, bëhet tepër e vështirë. Atij i duhet të përballet me gjënjeshtrën, me mashtrimin, me krimin, me korrupsionin, me mënjanimin, e madje dhe me kërcënimin e atyre që gjenden në të kundërtën e moralit. . . .

Megjithatë shoqëria shqiptare ruan në gjirin e saj mijëra individë, të cilët kanë zgjedhur e zgjedhin më mirë Sokratin e vuajtun se sa derrin e kënaqun. Dhjetëra e qindra pjesëtarë të shoqërisë sonë, në momentin e ndërrimit të sistemit, apo në katrahurat e viteve 1997-98, e më pas, kur vendi kalonte një kaos të organizuar, u lëshuan si hiena për të zhvatur e përvetësuar pasurinë e vënë me djersën e përbashkët. Por nga ana tjetër, mijëra e mijëra të tjerë të po kësaj shoqërie, nuk

tanë, në ç’ pozicion ndodhen?!


Normalisht këta zotërinj, përfaqësues e të zgjedhur të qytetarëve, duhej të rrezatonin figurën më të plotë të moralit, nivelin më të pastër të ndershmerisë, shkallën sipërore të përkushtimit. Po, a i kanë zgjedhur e përvetësuar liderët tanë politikë e shtetërorë këta parametra të vërtetë të ndershmerisë? Për fat të keq në raste tepër të rralla. Shumica kanë zgjedhur si model të jetës së tyre, jo Sokratin e vuajtun, por derrin e kënaqun. Kjo ka ndodhur e ndodh nga një llogari e thjeshtë: Të jesh Sokrat, si Sokrati i lashtësisë, është e lakmueshme, por pas emrit të famshëm vjen fjala i vuajtun. Këtë të fundit politikano-pushtetarët tanë nuk janë budallenj ta pranojnë. Atëherë mbetet “derra”, ashpërsinë dhe vulgaritetin e të cilit e zbut mbiemri “i kënaqun”. Ky mbiemër i hatashëm është mbiemri më i preferuar për një deputet, një ministër apo një politikan të dorës së parë. Dhe kënaqësia e fituar prej këtij mbiemri duket sheshit. Hidhuni në turmën e politikano-pushtetarëve të sotëm dhe, qysh në pamjen e parë do të konstatooni plot syresh me fizionominë dhe performancën e derrit të kënaqun, derrit tërë tul e dhjamë, që tri herë në ditë fërkon barkun dhe bën oh, oh, oh. Nëse do të kuturisje e ta ngacmoje ndonjërin prej këtyre, duke i kujtuar Sokratin e vuajtun, me një buzëqeshje diagonale ai do të ta kthente: “Pika ty dhe Sokratis tënd! Jeta njëherë jetohej or budalla!” Dhe do të vijojë të fërkojë barkun me atë filozofinë e derrit të kënaqun, që ia bën oh, oh, oh . . .

në atë shkallë, sa edhe qimja i shndrit e lëkura i llamburit. (Tani që shkruaj këtë frazë për derrin, mu kujtua pamja e një ministri, me flokë të shkurtër, me lëkurën kuq e bardhë, plotësisht si ajo e thiu të grazhdit...).

Mirëpo, në gjithë këtë përqendrim të derr-thiut, që majmet në grazhd, ka një sekret: Derr-thiu i grazhdit, aty nga 20-25 dhjetori (në prag të Krishtlindjeve), bie kurban i hanxharit të të zot dhe, nga frymorë i gjerdjeshëm kthehet në rosto e bërçolla për atë që e ka ushqyer për merak. I ziu derr-thi, po ta dinte se çfarë e pret në fund të dhjetorit, do të çante me noçkë gardhin e grazhdit e do të arratisë për të kërkuar azil politik në ato vende ku nuk e hanë mishin e derrit. Në pamundësi për të realizuar këtë, të paktën do të shpallte grevë urie. . . .

Morali? Tepër i qartë. Mund të jetosh si derr i kënaqun, por shumë shpejt do të përfundosh nën hanxhar. . . . Politikano-pushtetarët që kanë pranuar rolin e derrit të kënaqun, mund ti shpëtojnë hanxharit fizik të funddhjetorit, falë imunitetit që iu siguron ligji, por kurrsesi hanxharit të moralit të fund-jetës së tyre. Njeriu nuk duhet të jetojë si derr e aq më pak të vdesë si i tillë. Ja pse njerëzit e vërtetë pranojnë privacionet e jetës dhe mundohen t’i ngajnë Sokratis të lashtësisë.

Padyshim që nuk ka pyll pa derra. Në pyllin tonë “demokratik”, doemos ka dhe do të ketë edhe derra. Kjo është e pashmangshme. Por është në dorën tonë, në dorën e popullit, që këta derra të mos na



prekën as dhe një gozhdë, sepse morali i Sokratis nuk i lejonte. Dhjetëra e ndoshta qindra individë të sotëm, me e pa pushtet, përdorin njëmijë e një marifete, mashtrime, driblime dhe transformime deri në pështirosje, vetëm e vetëm se si të pasurohen, të rehatohen e të lumturohen në kurriz të të tjerëve, duke shkelur pa u skuqur mbi moralin, mbi dinjitetin, mbi veten dhe shoqërinë. Por në të njëjtën kohë kemi mijëra e qytetarëve të ndershëm, që kapardisen me djersën e ballit të tyre, duke ruajtun siç thotë kënga mirditore “Kësulën e bardhë si borë mbi vetull”.

Po qeveritarët, pushtetarët e politikanët


“Sokrat i vuajtun, apo derr i kënaqun”, dilemë e përhershme e jetës së njeriut. E para, ajo e Sokratis, rrugë e vështirë, me privacione, por e ndershme. E dyta, ajo e derrit, rrugë e lehtë, e rehatshme dhe lumturuese deri në derrosje, por pa nder e burrëri. Cilën të zgjedhim?!

Katolikët e veriut, sapo fillon vjeshta, zgjedhin nga tufa e derrave gicin më të mirë dhe, pasi e sistemojnë në një grazhd të rregulluar të veçantë, i bëjnë një trajtim ushqimor të zgjedhur. Derra, ose siç i thonë në këtë zonë, thiu, nga brumërat që kollofit, fillon e shëndoshet, dhjamoset, rrumbullakoset e qërohet (zbardhet)

dalin në krye të pyllit, se do të na e premierin të gjithin. Le ti lëmë andej nga fundi i përrënjeve të pyllit, gjer sa ta krahitim këtë të fundit dhe derrat ti çojmë në grazhdin e natyrshëm të majmërisë. I kemi mundësitë për ta realizuar këtë në rrugë paqësore, por nëse na bëjnë naze, le të përdorim edhe dhunën. Se edhe derrat e “pyllit tonë demokratik”, me hile, me mashtrime e me dhunë janë ngjitur në pushtetin e pamerituar.

*MIGJENI

Unë e urrej luftën-nuk vras dot njerëz



Përktheu **LEKË IMERAJ**,
shkrimtar, përkthyes, publicist

Në Luftën e Dytë Botërore, në Gjermani, të gjithë meshkujt, të moshës mbi katërmëdhjetë vjeç, duhej të paraqiteshin vullnetarisht, në qendrat e rekrutimit që, të mobilizoheshin për luftë. Ndryshe, do të merreshin forcërisht.

Një profesor i logjikës, kur e mësoi urdhrin, si i logjikshëm që ishte, u paraqit vetë, menjëherë. Që në takimin e parë me eprorët ushtarakë, ai ua bëri të qarta principet e tij mbi luftën: “Unë nuk mundem të luftoj. Nuk mund të vras njerëz, aq më tepër, ata që nuk më kanë bërë asgjë. Arsyen, përse unë nuk mund të vras, ua argumentoj: Unë kam studiuar logjikë dhe, nuk mund të bëj gjëra të palogjikshme. Lufta është gjëja më e palogjikshme që mund të bëjë njeriu. Ajo ka vrasjen dhe, vrasja është barbari. Unë jam njeri, nuk jam barbar. Lufta nuk është puna ime. Ai që pranon të futet në luftë, i duhet të vrasë. Nëse vret një njeri, në rrugë, mendoresh kriminel dhe, dënohesh. Nëse vret

dhjetëra, në luftë, mendoresh hero. Unë nuk dua të jem, as kriminel, as hero. Nëse ju duhet dikush, për bisedime me kundërshtarin, me atë që ju e mendoni armikun tuaj, jam gati. Këtë mund ta bëj shumë mirë unë”, sqaroi profesori.

Askush nuk ia vuri veshin argumenteve të tij. E urdhëruan të vishej me uniformën e rekrutit dhe, e dërguan tek fillestarët, në fushën e stërvitjes.

Stërvitja filloi me ushtrime rreshtore ku dëgjohej zëri i fortë i komandantit: Majtas, ktheu! Djathtas, ktheu! Para, marsh! Vend qëndro! Vend numëro!...

Të gjithë ushtarët ndiqnin me vëmendje komandat dhe, secili, mendohej të veponte sa më mirë.

Vetëm profesori, nuk lëvizte nga vendi, pavarësisht nga komandat që jepte oficeri.

Komandanti, disi i nervozuar, kur e pa njeriun statik, ngriti zërin. Për profesorin kjo nuk donte të thoshte gjë fare. Përsëri nuk lëvizte.

Komandanti e njihte atë dhe, nuk e pa me vend që ta qortonte, menjëherë, si një ushtar të thjeshtë. Pas stërvitjes e thirri dhe i tha: “Mos keni gjë problem me veshët? Ndoshta nuk dëgjoni mirë?”

Profesori iu përgjigj i qetë: “Nuk kam asnjë problem me veshët. Dëgjoj shumë mirë. Gjatë gjithë kohës i kam dëgjuar të gjitha komandat tuaja”.

Komandanti, i çuditur, duke menduar se, tani e mbërtheu, i tha: “Atëherë, si duhet ta kuptoj unë mos reagimin tuaj? Përse nuk i zbatuat komandat?”

“Përse”? u përgjigj profesori. “Kur të gjithë rrotullimet, djathtas, majtas, para, prapa dhe, ecjet para-prapa, në fund fare, na kthejnë në pikën e nisjes, çfarë fitojmë ne me këto lëvizje?”, kundërshtoi profesori

“Këtu nuk është fjala për të fituar por, për t’u stërvitur”, tha oficeri, i nevrkosur.

Profesori vazhdoi i qetë: “Unë nuk kam nevojë për stërvitje. Kam ardhur këtu të zbatoj urdhrin, jo të shkoj në luftë dhe të vras njerëz.” Komandanti tundi kokën, i revoltuar.

“Nuk ka ushtar që bën pyetje të tilla. Ju jeni i çmendur”, i tha ai.

“Për të palogjikshmit, logjika është çmenduri dhe, të logjikshmit, janë të çmendur. E di edhe këtë. Kjo është logjika e juaj. Por, unë nuk jam ushtar, jam profesor logjike. Unë u detyrova nga ligji që të vij këtu por, ju, nuk më detyroni dot, në kundërshtim me inteligjencën time, të kryej këso veprimesh prej budallai”, u përgjigj profesori i qetë.

Komandantit nuk i kishte ndodhur kurrë një gjë e tillë dhe, po vriste mendjen, për të gjetur një rrugëzgjdhje. Ky, më prishë edhe të tjerët, mendonte ai. Të gjithë e shikonë, qeshin dhe thonë: Të lumtë profesor! Shumë mirë profesor!

“E njoh”, i tha shefi. “Është shumë i njohur si profesor logjike. Ai kërkon që, gjithçka, ta kuptojë nëpërmjet pyetjeve. Mos u bëni merak! Do të merrem unë me atë”, e qetësoi shefi komandantit.

Shefi e thirri profesorin në zyrë dhe i tha: “Më vjen keq që ju shikoj këtu por, nuk kam çfarë t’ju bëj. Atdheu është në luftë dhe, i duhen ushtarë. Do t’ju jap një detyrë të posaçme që, nuk sjell probleme as për ju dhe, as për të tjerët. Ejani pas meje në kuzhinë”, i tha ai dhe i priu përpara.

Në kuzhinë, ai i tregoi profesorit një kazan të madh me bizele.

“Uluni këtu”, i tha ai profesorit. “Detyra e juaj është, të ndani bizelet e mëdha nga të voglat. Kaq. Pas një ore, do të vij t’ju

kontrolloj, për suksesin që keni arritur”, dhe u largua.

Kur u kthye pas një ore, për ta kontrolluar, e pa profesorin të ulur pranë kazanit, pa prekur asgjë me dorë. Shumë i revoltuar iu turr atij.

“Ç’është kështu me ju? Pse nuk keni filluar nga puna?”, i bërtiti ai me zë të lartë.

Profesori, fare i qetë, e shikoi drejtë në sy oficerin madhor dhe i tha: “Më mirë kursejeni atë të bërtiturën për njerëzit tuaj, të pa logjikë! Po ju them për herë të fundit, duke shpresuar se do të më kuptoni: Unë nuk do të bëj asgjë, nëse, nuk ma shpjegoni qëllimin e asaj që duhet të bëj. Ju më thatë që, të ndajë bizelet, pa më shpjeguar se, përse duhet ta bëj një gjë të tillë. Ju po më fyeri inteligjencën time. Mos vallë, me mendoni një idiot që, të merrem me bizelet? Dhe, përse kaq shumë bizele? Kjo është punë idiotësh. Pastaj, këtu, duke menduar, më lindën edhe disa probleme. P.sh. Ju më thatë që, të ndajë të voglat nga të mëdhatë por, këtu ka edhe mesatare. Ku t’i çoj unë ato, në cilin kazan? Nuk kam kazan për të tilla. Ju nuk më sqaruat asgjë, as arsyet, as kriteret”, u përgjigj profesori.

“Ju jeni i çmendur dhe, e dini qëndrimin tonë ndaj tipave të tillë”, i tha oficeri. “Megjithatë, nuk do t’ju vras por, do të urdhëroj t’ju mbyllin në çmendi”, vazhdoi ai.

Profesori qeshi me ironi dhe iu përgjigj: “Kjo nuk do të thotë asgjë për mua. I njoh principet tuaja. Aty ku komandojnë të çmendurit, të diturit dhe të shëndoshët vriten ose, në rastin më të mirë, mbyllën në çmendi. Ky ishte edhe fundi i Sokratit. E vranë se ishte i ditur, filozof. Këtë na mëson logjika e juaj”...

LAMTUMIRË SOSE GËSHTENJA, BLUZË BARDHA IDEALISTË E DUKAGJINIT

Ne të gjithë jemi miq kalimtarë të kësaj toke që na lindi. Vdekja është për frymë por s’ka derë, as dritare. Edhe një jetë super shekullare plot me miradi biologjikë nuk ja vlen pa nderë e pa shkruar në fund emrin (tënd si njeri i mirë). Sose Dedë Gështenja (Ahu) shkoj në amshim me 1 shkurt 2024 në moshën 71 vjeçare. Nuk e la sëmundja të plakej, por ajo e kishte vizatuar më parë portretin e vet si Çikë e mirë e Shoshit, grua e nderuar Toplane, buzëbardhë shembullore dhe aktiviste emancipimit të gruas.

Mos harroni bre se gruaja shqiptare e ajo dukagjinase vinte nga një botë e zymtë mesjetare e ndrydhur në absolutizmin patriarkal, varfëria dhe analfabetizmi. Qoftë në shkrime aq më tepër në folklor i këndojmë gjithë patos heroizmit të burrave dhe djalërisë, duke nënvleftësuar rolin e gruas si nënë, si motër si punëtore e luftëtare e jetës, por edhe kundër së keqes njerëzore.

Sose Gështenja lindi në fshatin Celaj

me 17 mars 1953 dhe ajo i përket gjeneratës të parë të vajzave Dukagjinase, që me sakrificë hyri në udhën e shkollimit, në një kohë kur për mendësinë orientale shkollimi i vajzave ishte tabu ose gjysmë tabu e kamufluar. Ç’i duhet shkolla Vajzave?! Ato duhet të mësojnë të përgatitën për tu martuar e bërë shtëpiake të mira! Meritë për shkollimin e Soses patën edhe baba Dedë (Çuni) dhe nena Drande, të cilët krahas edukatës së shëndoshtë familjare ia dinin vlerën shkollimit, prandaj sakrifkuan, u lodhën dhe e motivuan vajzën e fëmijët e tyre, që ti përkushtohesh shkollës.

Të shkollohej Soses i duhej të bënte çdo ditë 3 ore thike te poshtë nga Celaj në lumin Stupe, pastaj të ngjitej vertikalisht për tek shkolla 7 vjeçare në Palaj dhe anasjelltas. Udhën e beri mes shiut, bores, me duar të plasura prej morthit, duke shkelur me këmbë mbi skllotën e qulltë apo borën e ngrirë, por edhe e përkëdhelur prej flladit blerimore të shoqëruar nga

kënga e poetit më madh të natyrës, bilbilit të pyllit. Sosja e vogël zgjohej çdo mëngjes me rrezet e diellit që puthnin Elperin... Me çantën e librave krahaqafë, në opinga llastiku e çorape dhe me grykësen shkollore, fluturonte si flutur e gëzuar drejt çerdhes më të syzuar të diturisë që kishe Shoshi nder ato mote. Pas dite nderohej rrugës me diellin që merret udhën nga pas Buallit të Palajve, që i thoshte Shoshit natën e mirë.

Baba Dedë ishte me shenjë si punëmadh e tervestarë bujarësi, prind llogari kërkues dhe i dashur për fëmijët...

Një natë pranvere, Sosja në dritën e kandilit bëri detyrat. Te oxhaku, baba Dedë po pinte mendueshëm një cigare duhani, kur pa se vajza i futi fletoret në çante, e thirri-Sose: “hajde te tata!”

- Po baba, tha vajza e shkoi tue mendue se, mos po merrte ndonjë qortim.

- Sot takova mësues kujdestare. Më foli shumë mire, qoftë për sjelljen, qoftë për mësimet. Më foli mire, por mos të rritet mendja se, ka edhe dy muaj me përfundua shkolla. A din bijë se çfarë porosie më la?

- Mësuesja, jep gjithmonë porosi dhe këshilla të mira ia ktheu Sosja, pa e ditë, se çfarë kishte thënë mësuesja.

- Më tha: - Dede bëj çmos dhe çoje Sosën në shkollë të mesme në Shkodër e mos fut në punë të brigadës kaq të re.



- Bijo unë e kam nda mendjen me lanë vetën e gruan me disa gjana për me ta heqë prej shpine koshin e plehut dhe barrën e dushkut. Veç një gja kërkoi nga ti, të mësosh dhe të sillesh mirë si deri më sot!

- Të premtoj baba se, to bej të ndihesh mirë për mua!

Sosja e mbajti fjalën në vitet 1964-1968 mbaroj lavdërueshëm shkollën mjekësore, dega Infermier- Mami. Pas shkolle u emërua në vendlindje, duke qenë nder bluzë-bardhat e para të Shoshit. Vendi kishte shumë nevojë për

Dua të pi verë Çamërie

AGIM DESKU

“Internari” poetik i këtij autori është një autostradë nga ku veçojnë tri kors: Misioni si poet për t'i kënduar atdheut, flamurit dhe lirisë në mënyrën më të mirë, pasqyrimi i sakrificave supreme për atdheun e lirinë si dhe mirënjohja e vlerësimit për të gjithë ata që dhanë jetën dhe gjakun për çlirimin e Kosovës, për Çamërinë dhe trojet etnike.

Poezitë e tij përshkrijnë një rrugëtim të gjatë historik, fokusohen në pikat kulmore të këtij rrugëtimi, në personazhet më tipikë nga ata mitologjikë si Gjergj Elez Alia, Agroni e Teuta, Skënderbeu e deri në Jasharët e ditëve tona.

“Aireali” i tij poetik është kryesisht Kosovë, Shqipëri, Çamëri, Prekaz, Drenicë, Prizren, atdhe, bashkimi i trojeve amtare, kulla, besa,

Sakrificat dhe sublimi për lirinë.

Poezitë e këtij vëllimi poetik herë janë klithma të forta, herë lutje për të mirën e Kosovës e Çamërisë, here-herë betim solomn për flijimin e jetës për të ardhmen e begatë dhe lirinë, herë vargmale shprese, pranvera atdhetare, uragane atdhetarie, herë yje të ndritura të lirisë në trojet amtare, male obligimi e devotshmërie në shërbim të idealeve të mëdha të bashkimit e të lirisë.

Poezitë e Agim Deskut shfaqen si brerore të shqiptarizmit, të flamurit, të plisit të bardhë, të fjalës shqipe, si melhemi më i mirë i shërimit të plagëve të Kosovës e Çamërisë, si rrufe në qiellin Evropian për padrejtësitë dhe gllabërimin e trojeve etnike dhe si dielli rrezeartë i bashkimit të trojeve amtare.

Poeti ka një përkushtim të rrallë dhe një vizion të qartë për truallin amtar dhe bashkimin kombëtar. Kjo duket më së miri tek poezia “Çamëria” ku autori shprehet qartë dhe prerë: Jo/ Nuk e nënshkruaj/ kurrë pasaportën/ Pa miken Çame/ Nuk e dua lirinë i vetmuar/ Pa flamurin kuq e zi/ Të valëvitur me shqiponjë/ Në Çamëri/ As kokën pa tokën/ denbabaden Iliro-dardane./ Dhe më tej me ngjyrat e një Ylberi apelon: “ Sonte/ Kam të drejtë

të jetoj/ Të kërkoj liri për liri/ Ku denbabaden/ Isha zot vetë/ Isha Iliro-dardan/ ...Jam vet zot e Kastriot/ Jam Mic Sokol e Adem Jashar/ Jam Kosovë e Rugovë/ Jam Preshevë e Tetovë/ Jam malësi e Çamëri/ Jam shqiptar e jam Shqipëri/”

Poeti është mësues i gjuhës Shqipe e si i tillë lufton me tërë forcën e shpirtit dhe me forcën e fjalës artistike për mësimin dhe përvetësimin e kësaj gjuhe të nënës. Pa gjuhë e shkollë shqipe nuk ka liri . Kjo ide si obligim i poetit përshkon tërë vëllimin poetik, por më shumë spikat tek poezitë “Fjalë e pathënë”, “Kot është pranverë”, “Kot e kam fjalën”, “Mallkim i fjalës” etj. Me një trio vargësh të shkurtër e jep të plotë dhe të qartë këtë ide në poezinë “Kot është pranverë”. Kot është liri/ Pa fjalën shqipe/ Edhe në Çamëri/Kot është liri/ Pa emrin Shqipëri/ Si dikur në Iliri/.

Tërë vëllimin poetik “Dua të pi verë Çamërie” e përshkon zjarri i shpirtit atdhetar i poetit. Dhe ja si shprehet ai tek poezia “Fjalë e pathënë” : “ Po, atdheu nuk vritet/ As nuk matet me asnjë çmim/ Ai jeton në secilën zemër/ Të njeriut me plis të bardhë/ Një secilën fole të shqipeve/ Deri në Çamëri.../

Poeti krenohet me historinë e lavdishme kombëtare. Shpirti i tij bëhet behar, kur burrat e kombit mblidhen e lidhin besën, prandaj fokusohet mirë në këta momente kulmore dhe derdh gjithë muzën e tij si vlagë e tokës amtare nën rrezet e diellit pranverorë. Kjo del qartë tek poezia “U ringjallën zotat”. Poeti me të drejtë e quan mbajtjen e Lidhjes së Prizreni ringjallje zotash, se ajo u bë vërtetë një lloj Zoti në kuptimin figurativ dhe me platformën e saj zgjoi ndërgjegjen kombëtare e projektoi strategjinë e së ardhmes së mbarë të Kombit. Lidhur me këtë ngjarje kulmore për kombin shqiptar poeti Agim Desku shkruan: “Këmbëkryq/ Si burrat e odave në kuvend/ Në Prizren/ Në më të bukurin vend/ Të mbledhur/ Gjithë fisi ynë Kastriot/ Dardan, Alban e Çam/ Sot u ringjallën zotat/ Kohërat nuk vdiqën.../

Lufta shekullore me serbin, masakrimi, traumatizimi dhe gjenocidi i një populli të tërë ka lënë gjurmë dhe plagë të forta në

shpirtin e poetit. Luftës i ka kushtuar edhe poezinë me të njëjtin titull ku midis tjerash shprehet: “Tërë jetën e kisha pranë/ Në çdo cep të hijes së saj/ Ishte më shumë se fjalë/ Ish dramë, tragjedi e gjallë.../ dhe në këtë tragjedi të gjallë një nga aktet më të këqija që ka bregosur jo vetëm shpirtin e poetit, por të një populli të tërë martir, atij kosovarë është tradhtia. Pikërisht asaj poeti Agim Desku i ka kushtuar poezinë “Tradhtia” ku midis tjerave shkruan: “Nuk është në mesin e fjalëve të mia/ As në gjuhën e asnjërit nga miqtë e mi/ Jeton si hije mbi shkëlqimin e burrërisë, hijeve të së bukurës/ Dhe vdes në njeriun pa emër e atdhe.../ dhe më tej dedukton: “Nuk e quaj si fjalë të shkruar e të folur shqip/ Më besoni, nuk do të kisha dëgjuar kurrë për të/ Armiqtë e sollën si dhuratë për të prangosur lirinë/ E fjalës, të këngës dhe të emrit tim shqiptar/”

Liria dhe ata që falën jetën dhe gjakun e tyre për të, janë bërë brumi lëndor i formimit të poetit dhe prozhektorë më të fuqishëm që kanë ndriçuar e ndriçojnë “trasenë” jetësore të tij, por jo vetëm të poetit, por gjithkujt që i thotë vetes shqiptar. Ja si shkruan ai në poezinë “Populli e do lirinë” – “ Për çdo natë rri zgjuar/ Duke ruajtur kujtimet e çlirimtarëve/ Shkëlqimin e dritës në syrin tim/ Sot e shoh, e ndjej lirinë në shpirt” Shpirti i tij shpërthen si vullkan me mesazhin lapidar “ Jo më, nuk do të burgoset i tërë një popull që e do lirinë/ që i do ata martirë si Zotin, si shqipen e flamurit tim/”

Me vlagën e mirënjohjes dhe përlules respektuese për të rënë të lirisë poeti ndalet fort në disa poezi të këtij vëllimi poetik dhe tek poezia “U lartësuar në feniks” thekson: “Po, po hija e tyre është këtu/ Me shqipet hapërojnë/ Në altar të paqes e të drejtësisë/ ... Çdo ditë, çdo natë/ Trokasin në sofrat tona/ Veshur me vela-donin e fisnikërisë/ Qëndrojnë së bashku me lirinë.../”

Agim Desku vjen me vëllimin e tij poetik “Dua të pi verë Çamërie” si një profet duke apeluar për atdheun, për lirinë, për bashkimin e trojeve etnike. Nga ana tjetër ky vëllim poetik është një kamberë

e fortë për partnerët ndërkombëtarë dhe Bashkimin Evropian për të korrigjuar padrejtësitë në kurriz të Kosovës, Shqipërisë, Çamërisë e në përgjithësi të popujve të Ballkanit. Kjo sirenë alarmi për vënien në vend të padrejtësive shekullore ndaj popullit dhe kombit tonë si dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut ushton fuqishëm, qartë dhe saktë në poezinë “Dua të pi verë Çamërie” ku autori dedukton: “ Pse në shekullin e njëzet e një/ Dashuria ime rri varur nëçengel t' kohës/ Pse s'i ndej bukuritë e tua Çamëri/ Dhe të fillojë epoka e ligjshmërisë/ Tek varret e vëllezërve të mi/ Që janë tretur nëpër shi e stuhi.../ Hija e tyre çohet nga varret/ Me lot më përshëndesin/ Hajde bujrrëm në kullën e të parëve/ Në qilar kam ruajtur verë të mirë/ Të pimë për Çamërinë/

Kur lexon këtë vëllim poetik të poetit Agim Desku lexuesi unisohet, frymëzohet e ndërgjegjësohet, për të kontribuar në mënyrën më të mirë, për atdheun e lirinë. Ai krenohet me traditat e të parëve tanë dhe përulet me mirënjohje e respektin legjitim ndaj luftëtarëve të lirisë. Për këtë e shumë ide që poeti trajton në këtë vëllim poetik, ia vlen të lexohet e studiohet dhe, të pasurojë bibliotekat tona.

FAIK XHANI, studiues

Prezentimimi i pestë i librit poetik “Dua të pi verë Çamërie” i poetit Agim DESKU në Tiranë

Në Tiranë, më 17 dhjetor 2011, u zhvilluan dy veprimtari të BUKURA letrare. Në sallën e institutit/shkollës “Harry Fultz”, u promovua dy librat poetikë të Hyqmet Haskos “E përhershme është dashuria” dhe “S’ka faj zemra që të do”, ku me kumtesat e tyre u paraqitën Vullnet Mato, Prend Buzhala, Kozeta Zavalani, Namik Selmani, pellumb Goirica, Agim Desku Fadil Shehu etj, ndërsa këtë veprimtari të bukur letare e moderoi Albert Zholi. Me recitime nga krijmtaria e poetit, çaste të bukura dhuruan aktorja e njohur shqiptare Margariuta Xhepa dhe poeti Xhelal Luca. Ndërkaq, në mbrëmje, në ambientet e sallës “Pegasi”, në ambientet e Bar Kafe “Vrite Lotin” të poetit Perikli Shuli, u zhvillua një veprimtari e begatshme poetike nga Lidhja Ndërkombëtare e Poeteve, Shkrimtarëve dhe Artistëve “PEGASI” ALBANIA, me moto-temën “Jemi të gjithë Engjëj... E jani të bashkojmë krahët dhe të

personel mjekësore. Sosja e ndien me shpirt betimin e Hipokratit ndaj i shërbej me idealizëm, pasion dhe përkushtim bashkësisë ku lindi e lulëzoi si gonxhe dhe lumturohej që po ndihmonte ekonomikisht familjen, që kishte të ardhura të pakta.

Prindërit dhe Sosja ndihmuan në shkollimin e Palit (vëllait) për ekonomi Kontabël, i cili më pas do jepte kontributin e tij të çmuar në Shosh e Toplanë, duke u afirmuar si një ekonomist më laps të mprehtë dhe me integritet të lartë profesional.

Infermierja e re e pasionuar i ra kryq e tërthore, fshatrave të Shoshit e Toplanës, në çdo orë të ditës e natës në shërbim të sëmurëve, të lënduarve, grave shtatzëna, në lindje të vështira, kujdesit dhe vaksinimit të fëmijë.

Sose Gështenja ishte një luftëtare e palodhur e emancipimit (për higjien-

izimin e fshatit të banesave, aktiviste për pjesëmarrjen e grave e vajzave në veprimtaritë shoqërore, kulturore dhe artistike. Beri punë bindëse kundër lindjeve në shtëpi. Puna me rininë, gratë e shtypin ishin motoja e sajë si veprimtare shoqërore).

Sose Gështenja shkoi nga Shoshi në Toplanë 6 ore larg pa asnjë hatërmbetje për t'i shërbyer shëndetit publik. Ajo ishte bijë e dy prindërve punëtorë ndaj e desh punën dhe njerëzit e punës. Gjate punës në Toplanë gjeti edhe shokun e jetës, Gjokë Palë Ahun, nga një familje me vlera malësore. Zoti e vlerësoi dhe bekoj, duke sjellë në jetë tre fëmijë, secili e më i më i mire se tjetri (Shpresa, Kujtimi dhe Klediana) që i rrite, i edukove sipas shëmbëlltyrës tënde, i shkollove shumë mirë dhe i martove. Kur ishte në moshën për të shijuar ëmbëlsinë e mbesave dhe nipave Sose tu fik jeta. Ende herët sëmundja shituese

të mori, duke të bërë dasmoreshë për në amshim.

Sose Gështenja meriton të kujtohet dhe vlerësohet me respekt si luftëtare e një brezi idealist, që po perëndon dalë nga dalë si dielli në horizont pas maleve. Qindra e qindra orë pa gjumë, mijëra e mijëra ore punë jashtë orarit, miliona gjurmë ecejake, poshtë, lart e tërthorë, nga Bregu i Drinit deri në breg të Stupës, për të pritë lindje, lidhe plagë, bërë gjilpëra e vizita. Sa e sa here nga Ndreajt në Palaj, Mollë të Shoshit, Brashte, Serme e Gjon Micaç edhe mes natës acarit, shiut, bores e vapës vrapove për të bërë një gjilpërë e dhanë një serum., ndërsa sot edhe brenda spitalit as kush nuk ta shpon prapancën pa parë fytyrën e “Naim Frashrit”. Ka 30 vite që me nihilizëm e vandalizëm të harbuar mohuam dhe shkatërruam gjithçka.

Krijimi i gjeneratave të tilla idealiste profesionale dhe me integritet në çdo

fushë ishte një arritje e shkëlqyer, që përbën një nga analet më ndritura të shkollimit shqip të të gjitha kohërave.

Tipet e Sose Gështenjës dhe të ndjerave Linë Gjonja, File Kulla, Age Krypa, e të tjera (të më falin për kujtesë infermieret e tjera të këtij brezi të Shalës, Pulitit e Shllakut), të cilat i kemi vrarë pa mëshirë para se ndërronin jetë.

Sot ka plot infermiere më profesionale, por shumë, shumë më me pak e zemër bardha e me integritet se Sose e djeshme!

O njerëz, respektojeni punëtorin, që u përpoq me mish e me shpirt për ju!

Punëtorja e mirë Sose Gështenja u preftë në paq dhe Zoti e pastë në mëshirën e tij!

E paharruar jeta e puna e Infermieres Sose Gështenja-Ahu!

fluturojmë së bashku... Fluturimi starton nga qyteti çudi..." Kjo veprimtari e madhe "RRUGËTIM PROFIL PEGASI INTERNACIONAL" PROFIL.... 2010- 2012" u zhvillua me POETË, SHKRIMTARË, ARTISTË, STUDIUES. Mirëfillësia e një kreature letrare (si performohet nga organizatori), u performuan kultura e profilit për këta krijues: Kozeta Zavalani, poete, publiciste, Zëvendëspridinte e LNPSHA LNPSHA "PEGASI"ALBANIA dhe kryetare e Degës së Lidhjes për Tiranën *Hasije Selishta, poete, Presidente e LNPSHA "PEGASI" Kosova * Prend Buzhala, poet, studiues, Zëvendëspridinte i LNPSHA "PEGASI" Kosova (shpallet SHKRIMTAR I DALLUAR i Lidhja Ndërkombëtare e Poeteve , Shkrimtarëve dhe Artistëve "PEGASI" ALBANIA (me këtë rast ai mbajti një ligjëratë të shkurtër për letërsinë shqipe të Kosovës dhe për tërësinë hstoriko-letare të letrave shqipe që nga epoka ilire e deri më sot). * Hajrie Maçi, artiste e madhe e stilimit , Flutura Maçi, piktore e talentuar, Tiranë *Albana Zhuta poete , Strugë Maqedoni *Majlinda Rama, poete, gazetarë Zëvendëspridinte e Lidhjes së Krijuesve "PEGASI" ALBANIA *Mevludë saraçi, poete, publiciste , Kryetare e degës Gjakovë të LNPSHA "PEGASI" KOSOVA *

Shkëndije Hoda, poete, publiciste, zëvendës kryetare e Degës LNPSHA "PEGASI" Kosova për Gjakovën *Shefqet Dinaj, studiues, Gjakovë, Dega e LNPSHA "PEGASI",në Tiranë ia bëri prezentimin e pestë të librit poetik"Dua të pi verë Çamërie" dhe i çmimit të parë nga konkursi letrar të rinjtë e Çamërisë të poetit Agim DESKU,që e prezentoj Kristaq Shabani,ku autori pasi bëri një eveniment të prezentimit dhuroj librin dhe çmimin e parë që ka fitue në konkursin letrar të rinjtë e Çamërisë, për PEGASI ALBANIA, si dhe Rrugëtim talentesh që përvijojnë krenaturat: *Joaniana Merjo, poete, Tiranë *Anxhela Peza, poete, Tiranë *Osmon Bojaxhiu, poet, kryetar degës së LNPSHA "PEGASI" Kosova, për Sharrin. Në vazhdim pati edhe shumë e shumë paraqitje të tjera.

POEZIA SI KOHË DHE BASHKËKOHËSI


Nga Hyqmet Hasko Gjenia njerëzore ka shpikur artin, në përpjekjet për të njohur veten dhe botën që e rrethon, sidomos për të kuptuar të ardhmen e tij. Pozia është një gjini që shpreh shqetësimin e kohës, pasqyron një botë të mbushur me realitet të qenësishëm dhe kurrë nuk fle, por rri zgjuar në vetëdijen e krijusit, që vepra e tij të jetë gjithnjë e kohës dhe të jetojë më gjatë se koha fizike e poetit dhe bashkëkohësve të tij. Lidhur me këtë lind pytyja: a është poezia e sotme e vetëdijshme për të pasqyruar kohën, problemet që e shqetësojnë dhe i japin vetë fytyrën, nervin dhe pulsën kësaj kohe? Sa pra e realizon poezia jonë e kohëve të fundit dhe në cilësi? Lidhur me këtë a ka tema, mënyra organizimesh poetike që ta pasqyrojnë dhe të tregojnë cilësinë e saj? Kjo është pytyje që na shqetson të gjithë dhe për këtë duhen bërë studime nga studiues e kritikë profesionistë të artit poetik, të cilët për pamundësi financiare apo për shkak të

problemeve të tjera të jashtësisë së artit kanë rënë në heshtje dhe në një përgjumje të sforcuar, që nuk është e mirë dhe që sigurisht e dëmton artin si vetëdijen më finike të kombit.Praktika po tregon se pak njerëz poetë, shkrimtarë dhe disa gazetarë, më shumë në mënyrë reklamative se sa si evidentim problematikash poetike, po mundohen të bëjnë diçka në lidhje me këtë aspekt, por është krejt e pamjaftueshme.Dihet nga filozofia e lashtë dhe e re se koha është përmasa e realitetit objektiv, është dhe përmasa e artit. Qe poezia të jetë e kohës, varet se sa ajo shkrihet me ralitetin, si e percjell ajo emocionin e këtij realiteti tek bota e lexuesit, sa ndihet emociioni i gjallë i jetës njerëzore në masazhin

përthyer të pasqyruara të gjitha ngjyrat e ylberit. Bie fjala tek femra përcillen shkallët kohore të evoluimit dhe pjekjes, pra vajza është në kërkim të idilit dashuror, e sapodashuruar, e përmalluar, e grinder, e ndarë, e rebeluar, e çliruar, rishitas në kërkim të një përvoje tjetër erotike etj, etj.Nëna është dashuria e përhershme, ajo fillon te tundja e djepit me ninullat që ia këndon krijesës së saj, por ajo është e pandarë në çdo aspekt të jetes. Gjyshja është bartëse filozofike e jetës për nipërit dhe mbesat. Kështu çdo poet është i shqetësuar, në mënyrë të vetëdijshme që të percjellë me poezitë e tij kohën që jeton, me te gjitha shqetësimet dhe problematiken qe ajo mbart, nga gjërat e vogla

tin poetik mbarëkombëtar. Poetët Silvana Berki, Deshira Haxhi, Lindita Prenga, Pjeter Zefi, Albana Subashi si dhe Shpresa Besa lëvrojnë mrekullushëm temën e emigracionit, duke qenë të shpenguar nga frenimi i mediokritetit dhe spontanitetit, në poezin e tyra ka lirizëm, ka ndjenjë, emocion, që përkon mjaft bukur me kohën që jetojnë. Ndërsa poeti nga trojet shqiptare ne Maqedoni, Nehat Nuhiu bashkë me nje poete te re, shumë talentuar, sjellin me shumë vëretësi fabulën, ku sarkazma është prezente në çdo varg dhe që shërben mesë miri për të diskretitur të shëmturen që ndodh në shoqërinë tonë. Vullnet Mato në poezinë e tij trajton me shumë realizëm temën e ditës, shqetësimet që ka çdo qytetar në përballimin e vështirësive të individit dhe shoqërisë në rrugën e emancipimit dhe progresit. Ky poet pothuajse nder te vetmit po can me mjaftë guxim dhe poe sjell nje poezi totalisht ndryshe ka poezia qe ka shkruar dekada me pare, ne poezit e ketije poeti spikat dukeshem dashuria per njeriun e varfer ,ne vargjet e tije e ngre larte ndeshmerin e njeriut puntore,,por nuk le pa permendur dhe dukurin tjetere ate te shemturen,sic eshte kurpsioni pse je dhe ne arte.Ne poezin e kohes ka vendin e vete dhe poezia lirike intime erotike,,dhe kjo poezi trajtohet shum bukur nga poet te shumte,por une dote vecoja Rajmonda Mojsiun ,Besnik Meten, Haxhi Dikolli dhe shumë poetë tjerë që me finesën e tyre dëpërtojnë thellë në tematiken erotike dhe sjellin poezi më shumë arte,,pa e tepruar ne lakuriqesin e mendimit për te sjell poezi te baltosur me slogane termash metaforike që nuk percjellin emocion në poezi.—Mjaftë bukur ne poezin e kohes vjen dhe tema e peiszhit,,tem kjo levrohet bukur dhe shumë arte pothuajse nga shumë poetë me begram te madh artisike,por dhe nga poet te rinjë.Por më shumë ndjeshmeri dhe me madhështi po lëvrohet bukur tema e krenarise kombetare,,nje tem qe prek pothuajse cdo poet,ku me shum natyrshmeri kan sjell pozi ten je natyre mjaftë te re per krenarin kombetare,tema e flamurit si simboli madherimit per cdo shqiptare eshte mjaftë e prekeshme tek cdo poet dhe mjaftë e pelqyshme per cdo lexuse.Pra nëse poezia jonë përms dukurive dhe individualiteteve të larmishme synon të mbaj në fokus kohën e vet dhe i shërben asaj dhe të ardhmes, poetët që e lëvrojnë atë nuk duhet të pajtohen me skemat, klishtë që janë të vjetëruara, që janë jashtë kohës, të vonuara dhe anokronike, që e ngushtojnë objektivin e poezisë, kendvështrimet poetike, duke rralluar kërkimet dhe ngurtësuar format, duke sjelle patrajtësi krijimesh dhe mbartur një fenomen që nuk e çojnë poezinë përpara, në lartësinë e kohës.Pra poezia në thelbin e saj duhet të ketë fytyrën e kohës, siç kishite fytyrën e saj poezia e Rilindjes dhe e viteve 30, siç ka fytyrën e saj çdo poezi serioze që duhet të identifikohet me kohën dhe bashkëkohësit, me vetë bashkëkohësinë, si koncept praktik dhe metafizik, deri në kuptimin e profecisë poetike.

Nga Hyqmet Hasko



dhe kredon poetike. Praktika ka treguar se ka tema që përcillen bukur, me shumë emocion, me shumë fantazi dhe kjo është vënë re jo vetëm te poetët e një niveli të lakumueshëm si Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu, Koci Petriti, Sulejman Mato, Arben Duka, Vullnet Mato, Kozeta Zavalani, Rajmonda Moisiu e shumë poetë të tjerë të shquar apo më pak të shquar, por dhe tek poetët më të rinj siç janë: Namik Selmani, Silvana Berki, Ledianë Kapaj, Lindita Prenga, Albana Subashi, Shpresa Besa, Deshira Haxhi, Shqiponja Axhami etj. Këta poetë dhe të tjerë që nuk është vendi që të renditen të gjithë shquhen për frymën e re që sjellin në poezi, frymë që rri larg vulgaritetit dhe mënyrës së vjetëruar të të shkruarit poezi, pra këta praktikojnë teknika, struktura të reja dhe vënë në harmoni cilësitë më të mira që do një poezi e kohës së sotme. Në artin poetik të tyre frymon bukur pozia njerëzore, në to shkrihen mrekullushëm ekzistenca e të gjitha stinëve dhe ngjyrave, gjallon bukur realiteti objektiv, me të gjitha thyerjet, rëniet, digresionet, kthesat, dramet dhe dyzimet ekzistenciale. Në poezitë e këtyre poetëve koha është ndarë në stinë, si në natyrë dhe në jetën e njeriut dhe ne ekzistencen e çdo dukurie esenciale ndërtohen realitete poetike paralelele, krahasimtare dhe evidentuese të shpirtit të larmishëm njerëzor. Në poezitë e këtyre poetëve ka pranverë, verë, vjeshtë dhe dimër, ka vajzëri, mëmësi, pleqëri, dashuri dhe brengë, lot dhe gaz, dhimbje dhe trishtim, rënie dhe ngritje në projektionin e jetës, thjeshtë

dhe delicate, deri tek pasha e filozofisë së mbijetesës së brezave dhe të vetë modalitetit të kohës.KOHA DHE JASHTËKOHËSIA Koha është njejës, metodat shumë. Sepse e para nuk ndërton, ndërrojnë të dytat. Ndjeshmeria e poeteve ndaj kohes ndoshta duket me e hapur,në kapjen dhe trajtimin e problematikes sociale. Është dukuri e kohës lufta që bën njeriu për të përparuar dhe në mënyrë të gjithanëshme dhe ndeshja e tij me te gjithë faltoret frenuse e vonuse.Prej këndeje lind ideja se tema e luftës kundër dukurive frenuse dhe vonuse në një shoqëri demokratike, nuk mund të jenë të huaja për poezinë. Të tilla janë bie fjala fenomeni i korrupsionit, krimi dhe mafia, mediokriteti etj, që bëhen një pengesë serioze për ta çuar shoqërinë në shtigje të reja progresive. Trajtimi i temës sociale është një element pozitiv dhe e mban poezinë në bashkëkohësi, në kontakt me problematikat më të mprehta shoqërore. Ndryshe nga dogmat e socrealizmit, poezia e re bëhet interprete e shpirtit të bukur, që ngrihet mbi dhimbjet dhe plagët e kohës. Këtë dukuri mund ta shohësh të pasqyruar në poezitë e poetëve Namik Selmani, ku lëvrin jeta e gjallë njerëzore, ai jo vetem sjell të renë, por frymon bukur dhe në poezinë e prejardhjes se tij nga Çameria, të cilën e mbart si një klithmë dhe shpresë të pashuar. Po këtë temë eka trajtuar mjaft bukur, me akorde poetike të përpunuara dhe të gdhendura mjeshtërisht, dhe poeti nga Peja Agim Desku, i cili na fton të pimë verë Çamërie, të bëhemi njësh me shpirt

Luigj Gurakuqi: Shpallë, lajmëron zyrtarisht agjensitë kryesore europiane dhe Kancelarinë e Austrisë, mbi Pavarësinë.

(Zbulohet nga unë Agron Luka, në dt. 2 mars 2024, një Dokument me randësi të madhe, për historinë tonë të shek XX)

Në disa Dokumente të skanuara nga Fondi i Muzeut Historik Shkodër, që ndodheshin në Doshen Migjeni, të cilat pjesërisht m'i ka vënë në dispozicion studimi i ndjeri punonjës muzeumi, Paulin Perja dhe pjesërisht miku im i ndjerë, punonjës i muzeumit, Eduard Grishaj, me rastin e djegies nga goditja elektrike e një kompjuteri.

Nga Servisi ynë në Piacë, ku punon djali im u arit të shpëtohej vetëm memoria hard disku, dhe ato materiale të skanuara iu dorëzuan M.H.Shkodër. Ne ruajtëm një CD, por mqs programi nuk ishte kompatibël, Dosja Migjeni, nuk hapej. Më vonë iu gjet mënyra që u hapën.

Me dt. 2 mars 2024, mqs koincidonte edhe dita e atentatit kundra Luigj Gurakuqit, duke ia rihedhë një sy (për koincidencë një sy realisht, sepse me synin e djathtë nuk shikoj fare, nga sëmundja që po vuaj !), fare rastësisht zbulova dy Dokumente.

Rezulton se, Shpalljen zyrtarishte të Pavarësisë e ka ba Luigj Gurakuqi me një Dokument të hartuar në gjuhën frengjishte. Por, e pa besueshme, ky dokument paska përfunduar në duart, kthtrat e tentakulat e Sigurimit shqiptar të diktatorit E. Hoxha, ku në M.P.B., të vitit 1957, qenka ngiri-



tur një Drejtori Arkivi me drejtor një kolonel famëkeq i quajtur Veli Dedi. Ky e ka marrë këtë Dokument! E zhduku, sepse ky nuk u publikua askund, e zhduku me urdhër apo me iniciativë personale?! Mund të rigjendet?

Unë menjëherë, me aq sa kam mundësi, sepse jam edhe i pamundur nga shëndeti e publikova lajmin me dt. 2 mars 2024, në fb, lajmërova disa persona me randësi në vendin tonë, por askush nuk desh ta publikonte!!! E vetmia që i bani një koment dhe një pëpjekia pubikimi nga mediat e gjithë hapësinës tonë nacionale ishte prof. dr. Zenepe Dibra dhe Z. Ndue Sanaj i cili shprehu gatishmërinë e botimit.

Tashti, ja Dokumenti kryesor dhe ai tjetri, të cilët nuk lanë dyshime se deri ku asht futë Sigurimi dhe shteti i kohës i vitit 1957.

Falenderoj gazetën Dukagjini dhe drejtuesit e saj për gadishmërinë që më ofruan për botimin, respekte e përhëndetje nga Agron Gjovalin Luka.

AGRON LUKA



LULASH BRIGJA

- POETI DUKAGJINAS, QË SKALIT VARGJE KRENARIE PËR VENDLINDJEN -

- Është bukur dhe vështirë të flasësh për njerëzit pasi shpesh mendon, a mos ju ke hyrë në hak pasi nuk i përshkruan dot ashtu siç e meritojnë për të pasqyruar në formën reale vlerat njerëzore që bartin nga eksperiencat e tyre në fusha të ndryshme të jetës.

Një ndër intelektualët e mirëfilltë plot kulturë e dinjitet, është dhe shkrimtari, poeti, publicisti Lulash Brigja.

- Brigja u rrit e u arsimua duke plotësuar kërkesat e kohës qoftë për veten, familjen e shoqërinë e gjerë.

- Lulashi vlerësohet për pjekurinë intelektuale dhe aktivitetet e shumta si artist i palodhur e për këtë është vlerësuar nga Shoqata e Bashki të ndryshme me dhjetëra "Mirënjohje", "Çertifikata", e "Çmime Nderi" duke e bërë Lulashin një emër të spikatur në botën e Artit e Kulturës.

- "Çertifikata Mirënjohje" nga Bashkia Malësia e Madhe;

- Ambasador i Paqes Botërore;

- Shoqata Atdhetare "Dukagjini": "100 vite arsim e kulturë në Dukagjin" dhe "Mirënjohja e SHAD";

- Qendra e Artit dhe Kulturës Shqiptare;

- Shoqata "Folklori i Podgurit", Istog;

- Shoqata Rajonale e Shkrimtarëve. "Teuta", Prishtinë;

- Ora letrare në Rozhaje;

- Radio "Zëri i Mërgimtarit";

- Manifestim "Dita e Plisit", Klinë;

- Mirënjohja "Lukë Kaçaj" nga Shoqata Atdhetare "Malësia";

- Shoqata Kulturore "Jehona Shqiptare" në Tiranë;

- Festivali Folklorik "I këndojmë lirisë" në Klinë;

- Shoqata e Vëllazërisë Kosovë- Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" në Pejë;

- Vlerësohet për kontribut të çmuar, të dhënë në krijimtarinë artistike, i cili ka treguar respekt e vlerësim për Malësinë e Madhe, Dukagjinin apo treva të tjera të ndryshme në Shqipëri e Kosovë, duke shkruar dhjetëra e dhjetëra këngë për burrat e nderuar që ndërruan jo vetëm Malësinë, po mbarë Kombinin me gjithçka dhanë për Atdheun, duke i përjetësuar në vargjet e tij, e bërë të pavdekshëm tashmë përmes telave të lahutës, sharkisë e çiftelisë.

- Lulashi vlerësohet për ruajtjen, promovimin dhe pasurimin e vlerave të trashëgimisë Kulturore dhe Folklorike të trevës së Dukagjinit si krijues, poet e shkrimtarë i disa librave e vëllimeve me poezi a tregime.

Organizator i suksesshëm i "Sofrës së Dukagjinit" ndër vite; veprimtari kjo, që bashkon trevën edhe me viset më të skajshme të shqiptare kudo janë, duke bashkuar rreth vetes rininë dukagjinase, bij të devotshëm të asaj treve shumë shekullore, por dhe veprimtari të ndryshme artistike në qytetin e Shkodrës e më gjerë.

- Bashkëpunëtorë i shkëlqyer brenda fisnikërisë të malësorit, i gjendur fort në veprimtari edhe në shoqata të tjera nga Shqipëria e Kosova, për promovimin e artit dhe kulturës sonë kombëtare, prandaj dhe është vlerësuar me titullin "AMBASADOR PAQES - ALBANA" e plot çmime nderimi e vlerësimi për kontributin e tij të çmuar dhënë ndër dekada.

- Është bukur të flitet për letërsinë dhe artin e të shkruarit, të cilën e bëjnë njerëzit, madje njerëzit e mëdhenj. Dhe është detyrë e jonë, që punën e kontributin e këtyre njerëzve ta

publikojmë, duke u dhanë vendin e meritat e duhura.

- Pra është puna që vë në lëvizje universin, e kjo mbetet çelësi i suksesit të Lulashit, që me larinë artistike, thellësinë e gjerësinë e mendimit, origjinalitetin në krijim e prurje, e lartësojnë këtë njeri në vëmendjen e gjithkujt që e njeh.

Përveçse dy vëllimeve poetike, por dhe dhjetë vëllimeve me Tregime & Ese, ka arritur të hartojë katër Libra dokumentarë, Librete, Koncerte dhe Sofrat e Dukagjinit për njëzet vite. Në dhjetëra promovime libri ka qenë i pranishëm me recensione. Gjithashtu mbetet një promovues i palodhur i bjeshtëve të vendlindjes përmes aparatit fotografik, që mbetet mik i pandarë i tij. Dhe pas këtij pasioni të Lulashit fshihen sot mijëra foto të ruajtura ndër vite nga veprimtaritë kulturore e letrare, foto nga natyra e të tjera, që përbëjnë një minifototekë, vlerë të ruajtur me aq kujdes.

Brendia e këtij autori të vet organizuar ka një larmi të jashtëzakonshme veprimtarish ar-



tistike dhe letrare, duke lënë gjurmë sukcesi, e kjo e bën Lulashin unik.

- Unë si një kritike letrare që deri më tani kam recensuar rreth dyqind vepra, dua të sjell sa më të plota vlerat e artit letrar kryesisht në poezinë e poetit Lulash Brigja.

E pati thënë njëherë i madhi Ali Podrimja se, po të mos kisha qenë këngëtarë, nuk do isha bërë kurrë poet. Poetët punojnë me mendje e zemër prandaj janë artistë, dhe poezia është arti i frymëzimit të jetës. Por dua ta citoj edhe një varg shkreljan; "Mos u bëj poet, nëse nuk mund të lindësh në secilin varg, nuk mund të lindësh në secilën fjalë!" Thënie të fuqishme, që kumbojnë zëshëm tek çdo krijues, kryesisht tek ata që natën e kalojnë dhe gdhijnë me Penën.

- E them pikërisht kështu pasi seç ka një lidhje të ngushtë me poetin në fjalë e Penën e tij, sepse vargu poetik i poetit Lulash Brigja është filozofia e fjalës shkruar bukur artistikisht, e veshur me Metafora të fuqishme që e gjen tek çdo varg a strofë dhe poezi e autorit, ndonëse nuk mund të jetë absolute, pasi ka një lloj relevance, të cilën e jep nga eksperiencia e tij.

Me ty sikur hapet çdo rrugë a shteg / Udhëtova me ty në borë e në zheg / Kur fluturova ti krahë më dhe / Kur jam me ty unë ngjitem mbi re

Ti ishe çadër sa herë ra shi / Shpirtin e lagur, ma ngrohe në gj / Unë para teje në erë e në pluhur

/ Dhe mes shkretëtire, të qeshur / Dhe të lumtur / ...

"PËR TY"

- Vargje shpirti shkruar me gjak zemre, por dhe adrenalinë që shijon fjalën e vargun.

Janë këto vargje mirënjohjeje të shkruara nga Lulashi për njeriun e shpirtit, as' sesi nuk e fsheh dot lumturinë, por e shpreh me varg transparent ndonëse kujdeset që mos të flasë shpesh për të, por në këto vargje duket se dhe vargjet do i përputhë në rimë ashtu si në këngë, sepse të tillë janë artistët, por ishin pikërisht këto vargje zemre, që i shpreh për njeriun e duhur, atë që ia zbukuron jetën, i lehtëson dhimbjet, e shëron plagën me fjalën e duhur dhe gjestet plot gjenitale dhe në mënyrë të përsëritur e të vijueshme siç ju ka hije zonjave. Është bukur kur e ke, ama ende

turimit në lidhshmëri me fjalën, perceptimet a emocionet, por dhe zhvillimet që rrethojnë autorin. Frymëzimi, ky element që lind instinktivisht në mendjen e këtij poeti, ama percepton botën që e rrethon.

- E pasur është bota e poetit pasi krijimtaria poetike e Brigjës jep shkëlqimin në stile brenda gjinisë, që e lëvron ndër vite.

Mesazhet frymëzuese që përcjell tek lexuesi apo dëgjuesi, ndriçon shpirtat ky oazë i letërsisë shqiptare, ndaj është forca e brendshme që e pikas në simbolika qëndrese mbi të cilat sakrifkoi populli ynë, ndaj autori nuk resht kurrë apelin që sapo cituam.

Arti poetik i autorit është i ushqyer me moral të lartë njerëzorë dhe pas veprave të tij është forca e jashtëzakonshme poetike ku humor i nxjerr anën e brendshme të autorit, duke gjetur përfilljen e lexuesit dhe dëgjuesit.

Nëse bota e artit poetik të Lulash Brigjait hidhet poshtë, autori është i gatshëm të bëjë gjyq me perënditë, kjo falë vullnetit dhe aftësive të tij krijuese, pasi poezinë e trajton si ushqim për shpirtin, por dhe qetësues po ashtu.

Kur ishte ura nuk ishim ne / tani më thua, / Hajde ku je ky det i ndarjes, / s'po shterret dot, / Avullojnë shpresat mbushet me lot.

As bashkë s' po jemi, por as të ndarë, / Ti ëndërr e vdekur unë ëndërr e vrarë, / Dua të kujtoj një thënie e vjetër, / Mos lër asgjë për botën tjetër, / ...

Brigja vjen me një tjetër stil poetik në varg, në të cilën poezi të tilla i përshtaten shumicës së lexuesve, pasi vargjet sikur vajtojnë për të kaluarën dhe mosmundësitë apo fatin lig që të futin në përjetime ndjenjash njerëzore ata njerëz që ju ngjan se, kjo poezi është shkruar për ata pasi fuqia e vërtetë krijuese i abstragon, duke tejkualuar rastisjet apo koincidenat.

Refleksi dhe impulse mbi strukturën e ndërtimit poetik dhe gjenden tek shumë poezi të Brigjës.

- Aftësitë komunikuese me lexuesin e bëjnë atraktiv e të pëlqyeshëm brenda këtij arti mjaft të pëlqyeshëm dhe i vjetër sa vetë jeta, ndaj poezia e tij përbën thelbin poetik në krijimtarinë popullore shqiptare, me të cilat përcjell mesazhe dhe sikur tërheq vëmendjen me pikturat në vargje.

- Autori i shumë poezive, tekste këngësh, vëllimeve poetike ka zotëruar mjeshtërisht e me finesë fatet e tij, duke e kthyer në burime drite nga gjithë krojet

e mendimeve dhe me degët e shpirtit të trazuar i bie paq heshtjes mbi muzë, vargut i jep fjalë, freskon këngët e ecjes nëpër shkëlqimin e shpresave ku spikat talent e gjenialitet, ndaj autori spikat mbi metaforë.

Ky poet di të krijojë e pasurojë vargun, poezinë, këngët, vëllimet e shpirtat të lexuesve, të cilët herë i gëzon e herë i mallëngjen përmes muzës, ngacmimit apo filozofisë që fuqizon vargun, prandaj flasin për tërësinë poetike të autorit, pasi krijuesi e shpik nga mendja e tij, e vjen si burim për vargun, e mendimi aktivizohet lirshëm brenda ndjenjës.

Kështu që poezia e Lulash Brigjës, i cili mendon lirisht e shkruan mjaft profesionalisht paraqitet si një nga veçantitë në poezitë tradicionale.

Natës ia puthja yjet e fundit, / Borën e puthja pa rënë në tokë, / Shpesh i kam puthur valët e lumit.

Njomzën kur del e puthi me sy, / Di kur vrapoja të kapi flutura, / Herë puthja një e hënë puthja dy.

Mrizat e bjeshtës dhe krojet e bores, / Duke i puthur s'u lodha kurrë, / Se bukurinë e kërkon syri, / Kur t'jesh i ri e kur të jesh burrë, / Të dehesh me puthje, / ...

Vjen kjo poezi, plot dritë, jetë, frymëzim e filozofi. Është dashuria për natën, natyrën, borën e lumin, njomëzën, fluturën, hënën, bjeshkën e kroatet, gjithçka e gjithësinë.

Kjo formë dhe stil i veçantë poetik, që sjell vargje të bukura, të cilat flasin më shumë se vetë vargjet, pasi fjala filozofike është maja e Letërsisë bashkëkohore shqiptare dhe autori e ka arritur duke jetuar në mitin e krijimit, larg narratives.

Vargjet bëhen qëndrestare dhe kërkuese mbi ngritjen e vetëdijes popullore dhe asaj intelektuale.

E përgëzoj autorin, për mesazhet që përcjell duke treguar forcë e vetëdije dhe gjithmonë pozitiv.

Gjithçka që shkrova më lart për krijimtarinë letrare të poetit Lulash Brigja, vjen si punë, përgjegjësi e përkushtim, duke përdorur mekanizmat e lart përmendur jo vetëm si realizim dëshirash, por dhe kontribut përmes eksplorimit dhe realizimit të ëndërrove e duke u bërë udhërrëfyes për brezat, duke treguar kështu fuqi dhe kapital njerëzorë po 'ashtu me potencialin e tij në këto nivele. Një profesor në sytë e të gjithëve.

E mbyll me një thënie që kaq shumë i përshatet Lulash Brigja- jt.

- Autori ka sjellë qindra tekste këngësh që këndohen nga autorë të ndryshëm në mbarë trojet shqiptare brenda dhe jashtë kufijve dhe prandaj këndon zemra e autorit, pasi me forcën e fjalës dhe bukurinë në varg, strofë e tërësinë e saj sjell ajkën e këngëve, por kështu ndërtohet bukur struktura e poezisë dhe metafora si element bazë është filozofi më vete, e cila forcon e shton vlera poezisë dhe këngës duke i bërë të qëndrueshme e jetëgjata. Poezia e tij udhëton shtigjeve të largëta dhe dominon kohërat duke përcjellë mesazhe të fuqishme miqësore e njerëzore. Forca e fjalës, thellësia e mendimit, figurat letrare, që përdor i bëjnë vargjet e tij të veçanta në fushën e krijimtarisë folklorike .

• Tekstet e muzika

Letërsia dhe institucionet shoqërore patën, kanë e do kenë lidhshmëri mes tyre, që kur u krijuan ato, u përdorën lirikat gojore popullore që me shoqërinë primitive e më pas zhvillimet njerëzore filluan edhe të shkruheshin.

Letërsia nënshtron pa vështirësi të gjitha llojet dhe kriteret klasifikuese në gjinitë letrare si lirikë, epikë dhe dramë, që e kemi ndeshur shumë vonë në veprat folklorike shqiptare.

Këto gjini letrare ka shumë autor, që i kanë lëvruar dhe evolimi ka arritur kulmin dy shekujt e fundit.

Një nga krijuesit e këtyre gjinive është poeti dhe tekst shkruesi Intelektuali Dukagjinasi Lulash Brigja, ku vargëzon në poezi dhe gjithashu dhe tekste të bukura këngësh.

Autori ka krijuar tekste për autorë të shumë të e mjaft profesionistë, dhe ky është një ndër elementet e rëndësishme që vlen për t'u vënë në dukje dhe për t'u sjellë në vëmendjen e lexuesve.

Kështu që kam sjell shkurtimisht tekstet e disa këngëve dhe emrat e këngëtarëve, por dhe dueteve pasi vlera muzikore del në pah qoftë si tekste apo dhe interpretim pasi këta dy komponentë janë dominuese.

* Qysh se në tokë erdhi njerëzimi / Ku bashkohen lumi e drini / Krah për krah kullat i paten / Taraboshi me Rozafën / Se vetë Zoti e ka thane / Lum kush ka emrin shkodran / Se festojmë Bajram e Pashkë / Besë e nderë i kem

ruajt bashkë / ...

- Shkëputur nga kënga "KUPE DANJA" dhe kënduar nga këngëtarë Gjovalin Shani.

- Këto vargje karakteristike të gjinisë epiko - atdhetare e heroike, nga bota shqiptare, të krijuara nga autori Dukagjinasi Lulash Brigja, me domethënie të thellë e kuptim të shumë - anshëm, si pasuri e jashtëzakonshme dhe e pazëvendësueshme, që do mbijetojë për hire të fuqisë krijuese ka pasuruar folklorin muzikorë, që mbetet aktiv ndër trevat tona, duke shprehur ekzistencën e muzikës me vokalitet, me të cilën dhe këngëtarë, që e ka kënduar këtë këngë, z. Gjovalin Shani, përjetëson këto vargje me shumë vlerë, dhe interpretimi i tij brilant, por dhe histori që rrëfen vargu e kënga nëpërmjet zërit të jashtëzakonshëm që fal kënaqësi për njerëzinë përmes vargut, zërit, timbrit, vokalit dhe adrenalinit që ngre në mjedise të ndryshme dhe i bën ato aq të gëzueshme, kështu që kjo këngë historike ka zënë vend në zemrat e art - dasheve të këngës e muzikës popullore tradicional e folklorike.

E vërteta e pa mohueshme është se, asgjë nuk tretet, por mund të transformohet, prandaj kënga thotë 'besë e nderë i kem ruajt bashkë' duke mbetur mjaft stabile.

Karakter fantastik i rrëfimit.

* O ju djem që keni ikë në Gjermani e Amerikë / Atje larg në Australi, në Greqi e Suedi / Ku me gjetë shokun e jetës / Hajt e merrni mjaltnin e bletës / E me ra në dashuri s'ka si vajzat në malësi / Nëse don me marrë sorkadhe / Shko në Kelmend të Malësisë së Madhe / Në don me marrë lulet e blinit / Në Has e Grudë përtej kufirit / ...

- Shkëputur nga kënga "S'KA SI VAJZAT NË MALËSI" dhe kënduar nga këngëtarja Elvira Fierza.

- Vargjet e kësaj kënge të bukur me karakter lirik të shkruara nga autori Lulash Brigja, shpreh shqetësim dhe krenari kombëtare.

Së pari, shqetësimi i thellë ndjehet për largimin e rinisë shqiptare ndër vendet e huaja ashtu siç është interpretuar nëpër vargjet e këngëve, fenomen që prek pothuajse çdo familje shqiptare, pasi çdo ditë e themi apo më saktë ankohemi për bastisjen e trojeve nga fenomeni i emigrimit.

Dhe fakti tjetër, në vargje është se, bukuria e femrës shqiptare është ajo larmia që ngjall ndjenjë dhe emocion në varg, por dhe aftësia interpretuese e këngëtares, zëri, timbri, vokali, xhirimi e të tjera, janë tjetër elemente shtesë, që bukurinë e vargut e përçojnë në formën më të këndshme e bëhet deri lakmitare për nivelin, por dhe për ta ridëgjuar dhe e arsyeshme të meditohej si element i jashtëm i këngës, ndërsa ana e brendshme e saj të fut ndër sferat semantike të vargut.

* Moj Kosovë o moj martire / Gjak dardan e tokë ilire / Porsi shqipja me dy krena / Bashkë kem qënë e bashkë do jena / Kemi një gjuhë e një flamurë / Nuk jem nda as ndahem kurrë / Amanet moj shqipe / Bëjini bashkë trojet etnike / ...

- Këngë e shkëputur nga "AMANET TI MOJ SHQIPE" kënduar nga këngëtarët Fatmir Berisha e Gjelosh Hajdari.

'Shpirti i poetit i këndon Atdheut'!

Zemra e këngëtarëve ju këndojnë bashkimit kombit, por zëshëm vijnë vargjet plot ndjenjë dhe përcjellin emocion e dhimbje mbi gjakun dardan dhe trojeve tona Iliriane, duke krahasuar vendet tona, shqipen me dy krena ashtu siç flet realiteti shumë shekullorë dhe dëshirën e vetme, për të qënë bashkë e duke

kultivuar një gjuhë e identifikuar nga një flamur kombëtarë, Flamurin Kuq e Zi.

Mendimi teorik duket se ka avancuar në atë praktik në rrugëtimin mbi folklorizmin, duke përshtatur relacionin me motivin si çështje brenda klasifikimit, që njëri vjen si element etnografik e tjetri si komponent i qenësishëm që poezinë e bën këngë dhe të zhvilluar nga ana dialektike.

Kjo e si kjo këngë tipike liriko - patriotike e plot atdhetarizëm mbajnë gjallë frymën kombëtare, duke i parapri bashkimit pasi vuajtëm ndarjet shekullore dhe përcjell ndjenja e emocione mbi këtë çështje, që gjithmonë lëngon pasi ka prekur rëndë çështjen tonë etnike.

* Moj e mira në orteg të bores, / Moj lulëkuqja e Kosovës, / Atë jelek me fije ari, / Kush ta bleu a kush ta fali?

O skifter i rritur në bore, / Mos i prek shqipet me dorë, / Se jelekun kuq e zi, / Ma kanë ble vllëznit e mij

Kënga jonë ushton krenare, / Krenari e alpeve shqiptare, / Kënga jonë vjen si kushtrim, / Për Malësi e Dukagjin.

Kënga jonë nuk shterron kurrë, / Në Rugovë, Nikaj Mërturë, / Kënga jonë bëhet kreshnike, / Veç për ty Shqipëri Etnike. ...

Këngë e shkëputur nga; "SI NDAN KUSH ALPET SHQIPTARE", kënduar nga dueti i mrekullueshëm Nikolin Përpali dhe Besnike Berdynaj.

- Vargje mjaft interesante plot bukuri dhe estetike, që frymojnë atdhetari e bashkim.

Ndonëse fillimisht të ngjan si një lirikë dashurie dhe mjaft e bukur ajo në thelb ka kushtrimin e bashkimit ashtu siç flet titulli 'Si ndan kush Alpet Shqiptare'.

- Pra lehtësisht dallojmë anën e brendshme dhe të jashtme tek kjo këngë qoftë teori apo dhe praktikë qoftë ajo.

Pra, ana e jashtme që i bie ekzekutimit është perfekt nga këngëtarët, duke vënë në pah elementet muzikore dhe pamja vizuale mjaft e organizuar. Kurse tekstura ka vlera të larta artistike të gërshetuar bukur me gjuhën poetike si tema e këngës, ideja a motivi gjithçka ka shkruar e organizuar dhe ekzekutuar bukur artistikisht në bazë të tematikës dhe motiveve gjithashtu apo dhe brendësisë.

Pra, relacioni ritual dhe motivi janë komponentë që gërshetojnë motivet në këtë këngë, por pothuajse në gjithë tekstet e këngëve, të cilat autori i teksteve Lulash Brigja ka shkruar për shumë interpretues nga troje të ndryshme të etnisë sonë si lirika të shkruara, për tema mjaft interesante, duke u bërë pjesë e pandarë e folklorit shqiptarë ku gjejnë dhe pika takimi.

- Solla disa stile nga gjinitë e muzikës popullore të trevave të malësisë së Dukagjinit, por dhe të Kosovës, me karakter atdhetar dhe tekste të shkruara nga Lulash Brigja. Nuk ishte qëllimi për të sjellë veçse këto pak këngë, por arsyeja është se dhjetëra e dhjetëra tekste të tjera këngësh të shkruara nga ky tekst-shkrues janë të kënduara nga autorë në zë nga këto treva po kaq të bukura e atdhetare. Duke u marre me këtë studim jam thelluar për dëgjuar shumë nga këto krijime, por edhe vlerësimet e miqve të përbashkët janë me superlative, për penën e tij krijuese. Do të isha shumë e interesuar, por edhe këmbëngulëse, që të gjitha këto tekste, rapsodi në një të ardhme të afërt të ishin në një botim,

që të mbeten si një pasuri jo vetëm për autorin, por edhe për gjithë trashëgiminë ndër breza.

I uroj autorit sa më shumë krijimtari në tekste këngësh që të magjepsësh jo vetëm këngëtarët, por dhe dëgjuesit. Po ashtu edhe këngëtarëve shumë suksese e zëri tyre të buçasë kudo nëpër botë, ku dëgjohej, vlerësohet kënga dhe fjala shqipe.

• Nga librete-dokumentarë

Pothuajse gjitha koncertet dhe veprimtaritë folklorike të Dukagjinit janë me libretet e përgatitur nga mendimi artistik i këtij krijuesi shumë dimensional

Fantazia e tij nuk din të ndalet në të bërit art, pasi çdo ditë mendon e vepron, duke lartësuar dhe promovuar figurat të çdo profesioni. Normalisht për të bërë këtë punë duhet shumë kohë, studime, njohuri por edhe talent.

Këtë fakt e kompletton më së miri me libretet e tij të përgatitura me kujdes deri në detaje.

Sjell shkurtimisht disa impresione, që përjetova, duke i ndjekur ata në youtube

Në dy prej tyre autori vlerëson dhe përjetëson dy miq të tij, që fatkeqësisht nuk jetojnë më. Ata ishin nga intelektualët dhe burrat më të njohur e që pati ajo zonë, Doktorit i Dukagjinit z. Prelë Gjeloshi dhe misionari i Paqes z. Gjergj Prozhmi nga fshati Kir. Njerëz të mëdhenj, me zemër të madhe e me kontribute të veçanta që lanë, do të mbeten në histori shembull frymëzimi e përkushtimi, simbol krenarie për familjaret dhe shoqërinë.

Jo vetëm autori, por edhe miq e ish-koleg, i kujtojnë me përlulesi e shumë nostalgji burra te jashtëzakonshëm në formim, sjellje dhe cilësitë e rrallë që kishin. Të shkëlqyer në madhësinë e punës, të paharruar për inteligjencë dhe humanizëm. Figura të tilla të ndritshme i bëjnë nder Dukagjinit, Shkodrës dhe Kombit.

Këto janë dokumentarë të trajtuar me të gjithë elementet cilësore të Alpeve Shqiptare, duke nxjerrë në dritë vështirësitë që kanë kaluar ndër shekuj ato vise për shkak të terrenit të thyer, kujdesin e përkushtimin, nderin e moralin e lartë, punën sfiduese, mikpritjen e të tjera.

Vlerësoj lart përkushtimin e pasiq të artistit Dukagjinasi Lulash Brigja dhe punën e madhe dhe plot vlera, në të cilin mbjell virtyte nga vetja dhe përcjell mesazhe të vyera për gjeneratat.

Të thuash 'artist' është e thjeshtë, por të bëhesh artist është një punë, që kërkon ide e mendim të qartë, informacion, përkushtim e mjete deri dhe logjistike, të vësh në punë institucione dhe të ndjekësh veprimtarinë deri në përmbjellje të misionit të nisur, duke u bërë reflektues mbi të shkuarën dhe sfidues mbi të ardhmen.

Më vjen mire, Dukagjini i historisë dhe legjendave, Dukagjini i artit, i kulturës, i bjeshkëve të bukura e ka një poet dhe krijues si Lulash Brigja, që punon me pasion për të lënë gjurmët e tija krijuese dhe artistike.

I uroj shumë suksese dhe të mbetet shembull e frymëzim për brezat e së ardhmes.

Dukagjini, Shkodra dhe mbarë Shqiptaria i shpreh mirënjohjen për gjithë kontributin e çmuar ndër vite!

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj

Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:

Zotni BESIM PROGNI,
me banim në Irlandë

